

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 10

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij SNRF-je është të vendosë parimet për paraqitjen dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, kur një njësi ekonomike kontrollon një apo më shumë njësi të tjera ekonomike.

Realizimi i objektivit

- 2 Për të arritur objektivin në paragrafin 1, ky SNRF:
- (a) kërkon që njësi ekonomike (*shoqëria mëmë*), që kontrollon një apo më shumë njësi të tjera ekonomike (*filialet*), të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara;
 - (b) përkufizon parimin e *kontrollit*, dhe përcakton kontrollin si bazë për konsolidimin;
 - (c) përcakton se si aplikohet parimi i kontrollit për të identifikuar nëse një investitor kontrollon një njësi të investuar dhe kështu që ai duhet të konsolidojë njësinë e kontrolluar;
 - (d) përcakton kërkesat e kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara; dhe
 - (e) përkufizon një njësi ekonomike investuese dhe përcakton një përjashtim për konsolidimin e filialeve të veçanta të një njësie ekonomike investuese.
- 3 Ky SNRF nuk merret me kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit dhe efektin e tyre në konsolidim, përfshirë dhe emrin e mirë që rrjedh nga një kombinim biznesi (shih SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*).

Objekti

- 4 Një njësi ekonomike, që është një shoqëri mëmë, do të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara. Ky SNRF aplikohet tek të gjitha njësitë ekonomike me përjashtim sa më poshtë:
- (a) një shoqëri mëmë nuk duhet të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara, nëse ajo plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - (i) është një filial i zotëruar plotësisht ose një filial i zotëruar pjesërisht nga një njësi tjetër ekonomike dhe të gjithë pronarët e tjerë, duke përfshirë edhe ata që nuk kanë të drejtë të votojnë, janë të informuar dhe nuk kundërshtojnë faktin që shoqëria mëmë nuk paraqet pasqyra financiare të konsoliduara;
 - (ii) instrumentet e saj të kapitalit neto ose ato të borxhit nuk tregtohen në një treg publik (në bursa të vendit ose të huaja ose në një treg jashtë burse, duke përfshirë tregjet lokale dhe rajonale);
 - (iii) nuk ka regjistruar, as nuk është në procesin e regjistrimit të pasqyrave të saj financiare në një komision të letrave me vlerë ose organizatë tjetër rregullatore, me qëllim emetimin e çdo klase instrumentesh në një treg publik; dhe
 - (iv) shoqëria mëmë përfundimtare ose çdo shoqëri mëmë e ndërmjetme e saj ndërton pasqyra financiare të konsoliduara të cilat janë gati për përdorim publik dhe në pajtim me SNRF-të. Në këto pasqyra, filialet konsolidohen ose maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me këtë SNRF.
 - (b) [fshirë]
 - (c) [fshirë]
- 4A Ky Standard nuk zbatohet për planet e përfitimeve pas-punësimit ose plane të tjera afatgjata të përfitimeve të punonjësve për të cilat zbatohet SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*.
- 4B Nëse një shoqëri mëmë, që është njësi ekonomike investuese, i kërkohet, në përputhje me paragrafin 31 të këtij SNRF, t'i masë të gjitha filialet e saj me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nuk i nevojitet të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara.

Kontrolli

- 5 Një investitor, pavarësisht nga natyra e përfshirjes së tij me një njësi ekonomike (të investuarin), do të përcaktojë nëse është një shoqëri mëmë duke vlerësuar nëse ai kontrollon të investuarin.
- 6 Një investitor kontrollon një të investuar kur është i ekspozuar, apo zotëron të drejta për kthimet e ndryshueshme nga përfshirja e tij me të investuarin dhe ka aftësinë të ndikojë në këto kthime përmes fuqisë së tij mbi të investuarin.
- 7 Pra, një investitor kontrollon një të investuar nëse dhe vetëm nëse investitori i ka të gjitha karakteristikat në vijim:
 - (a) fuqinë mbi të investuarin (shih paragrafët 10–14);
 - (b) ekspozimin ose të drejtat për kthimet e ndryshueshme nga përfshirja e tij me të investuarin (shih paragrafët 15 dhe 16); dhe
 - (c) aftësinë për të përdorur fuqinë e tij mbi të investuarin për të ndikuar në shumën e kthimit të investitorit (shih paragrafët 17 dhe 18).
- 8 Një investitor do të marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat kur bën vlerësimin nëse ai kontrollon një të investuar. Investitori do të rivlerësojë nëse ai kontrollon një të investuar, kur faktet dhe rrethanat tregojnë se ka ndryshime në një ose më shumë prej tri elementeve të kontrollit, të renditura në paragrafin 7 (shih paragrafët B80–B85).
- 9 Dy ose më shumë investitorë kontrollojnë kolektivisht një të investuar, kur ata duhet të veprojnë së bashku për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme. Në raste të tilla, asnjë investitor nuk kontrollon në mënyrë individuale të investuarin, megjë asnjë investitor nuk mund të drejtojë veprimtaritë pa bashkëpunimin e të tjerëve. Çdo investitor do ta kontabilizonte interesin e tij tek i investuari në përputhje me SNRF-të përkatëse, të tilla si SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje dhe Sipërmarrjet e përbashkëta* ose SNRF 9 *Instrumentet financiare*.

Fuqia

- 10 Një investitor ka fuqi mbi një të investuar kur investitori ka të drejta ekzistuese që i japin atij aftësinë aktuale për të drejtuar *veprimtaritë e rëndësishme*, d.m.th. veprimtaritë që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në kthimet e të investuarit.
- 11 Fuqia lind nga të drejtat. Ndonjëherë vlerësimi i fuqisë është i drejtpërdrejtë, si në rastin kur fuqia mbi një të investuar është vendosur drejtpërdrejt dhe vetëm nga të drejtat e votës, të siguruara nga instrumentet e kapitalit neto të tilla si aksionet, dhe mund të vlerësohet duke marrë parasysh të drejtat e votës nga këta aksion mbajtës. Në raste të tjera, vlerësimi do të jetë më kompleks dhe kërkon të merret parasysh më shumë se një faktor, për shembull kur fuqia rrjedh nga një ose më shumë marrëveshje kontraktuale.
- 12 Një investitor, me aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme, ka fuqi edhe nëse të drejtat e tij për të drejtuar ende nuk janë ushtruar. Evidenca, që investitori është marrë me drejtimin e veprimtarive të rëndësishme, mund të ndihmojë për të përcaktuar nëse investitori ka fuqi, por, në vetvete, një evidencë e tillë nuk është përfundimtare në përcaktimin nëse investitori ka fuqi mbi një të investuar.
- 13 Nëse dy ose më shumë investitorë kanë secili të drejta ekzistuese, që u japin atyre aftësi të njëanshme për të drejtuar veprimtari të rëndësishme të ndryshme, investitori, i cili ka aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë, që në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në kthimet e të investuarit, ka fuqi mbi të investuarin.
- 14 Një investitor mund të ketë fuqi mbi një të investuar edhe në qoftë se njësitë e tjera ekonomike kanë të drejta ekzistuese, që u japin atyre aftësinë aktuale për të marrë pjesë në drejtimin e veprimtarive të rëndësishme, për shembull kur një njësi ekonomike ka *influcencë të konsiderueshme*. Megjithatë, një investitor që zotëron vetëm të drejta mbrojtëse nuk ka fuqi mbi një të investuar (shih paragrafët B26–B28), dhe rrjedhimisht nuk ka kontroll mbi të.

Kthimet

- 15 Një investitor është i ekspozuar apo zotëron të drejta ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e tij me të investuarin, kur kthimet e investitorit, nga përfshirja e tij, kanë mundësinë të ndryshojnë si rezultat i performancës së të investuarit. Kthimet e investitorit mund të jenë vetëm pozitive, negative ose tërësisht pozitive dhe negative.

- 16 Edhe pse vetëm një investitor mund të kontrollojë një të investuar, në kthimet e një të investuari mund të ketë pjesë më shumë se një palë. Për shembull, zotëruesit e interesave jo-kontrolluese mund të kenë pjesë në fitimet ose shpërndarjet e një të investuari.

Lidhja midis fuqisë dhe kthimeve

- 17 Një investitor kontrollon një të investuar, nëse investitori ka jo vetëm fuqi mbi të investuarin dhe ekspozim ose të drejta ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e tij me të investuarin, por, gjithashtu, ka aftësinë të përdorë fuqinë e tij për të ndikuar në kthimet që i takojnë nga përfshirja e tij me të investuarin.
- 18 Kështu, një investitor që zotëron të drejta të vendimmarrjes do të përcaktojë nëse ai është kryesori apo një agjent. Një investitor që është një agjent, në përputhje me paragrafët B58–B72 nuk kontrollon një të investuar, kur ai ushtron të drejtat e vendimmarrjes, që i janë deleguar.

Kërkesat e kontabilitetit

- 19 Një shoqëri mëmë do të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara duke përdorur politika kontabël uniforme si për transaksionet, ashtu dhe ngjarjet e tjera në rrethana të ngjashme.
- 20 Konsolidimi i një të investuari do të fillojë nga data që investitori ka fituar kontrollin mbi të investuarin dhe do të pushojë kur investitori humbet kontrollin mbi të.
- 21 Paragrafët B86–B93 japin udhëzime për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Interesat jo kontrolluese

- 22 Një shoqëri mëmë do të paraqesë interesat jo kontrolluese në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar brenda seksionit të kapitalit neto, veçmas nga kapitali i pronarëve të shoqërisë mëmë.
- 23 Ndryshimet në interesin e pronësisë së një shoqërie mëmë në një filial që nuk çojnë në humbjen e kontrollit nga shoqëria mëmë mbi filialin, janë transaksione të kapitalit neto (d.m.th. transaksione me pronarët në cilësinë e tyre si pronarë).
- 24 Paragrafët B94–B96 japin udhëzime për kontabilizimin e interesave jo kontrolluese në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Humbja e kontrollit

- 25 Nëse një shoqëri mëmë humb kontrollin mbi një filial, atëherë ajo:
- (a) çregjistron aktivet dhe detyrimet e ish-filialit nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar.
 - (b) njeh me vlerën e drejtë çdo investim të mbetur në ish-filialin kur ka humbur kontrollin dhe më pas e kontabilizon atë dhe çdo shumë, që ka si detyrim nga ose për filialin, në përputhje me SNRF-të përkatëse. Ky vlerë e drejtë interes i mbetur rimatet sipas kërkesave të paragrafëve B98(b)(iii) dhe B99A. Vlera e drejtë e ri matur në datën e humbjes së kontrollit do të konsiderohet si vlera e drejtë e një aktivi financiar në njohjen fillestare në përputhje me SNRF 9 ose kostoja në njohjen fillestare e një investimi në një sipërmarrje të përbashkët apo pjesëmarrje, nëse është e zbatueshme.
 - (c) njeh fitimin ose humbjen neto nga humbja e kontrollit në lidhje me interesin e kontrollit të mëparshëm, siç cilësohet në paragrafët B98–B99A.
- 26 Paragrafët B97–B99A udhëzojnë mbi trajtimin kontabël të humbjes së kontrollit në një filial.

Përcaktimi nëse një njësi ekonomike është njësi ekonomike investuese

- 27 Një shoqëri mëmë do të përcaktojë nëse ajo është një njësi ekonomike investuese apo jo. Një njësi ekonomike investuese është një njësi ekonomike që:
- (a) merr fonde nga një ose më shumë investitorë me qëllim që t'u japë këtyre investitorëve shërbime të menaxhimit të investimeve;
 - (b) angazhohet përpara këtyre investitorëve që qëllimi i biznesit të tij është që të investojë me qëllim përfitimi vetëm nga rritja e vlerës së kapitalit, ose vetëm nga të ardhurat nga investimi, apo nga të dyja bashkë; dhe

- (c) mat dhe vlerëson performancën e pothuaj të gjithë investimeve të tij në bazë të vlerës së drejtë.

Paragrafët B85A-B85M japin udhëzimet përkatëse të zbatimit.

- 28 Në rastin e vlerësimit nëse ajo plotëson përkufizimin e përkufizuar në paragrafin 27, një njësi ekonomike do të konsiderojë nëse ajo ka karakteristikat tipike të një njësie ekonomike investuese si më poshtë:
- (a) ajo ka më shumë sesa një investim (shiko paragrafët B85O-B85P);
 - (b) ajo ka më shumë sesa një investitor (shiko paragrafët B85Q-B85S);
 - (c) ajo ka investitorë që nuk janë palë të lidhura me njësinë ekonomike (shiko paragrafët B85T-B85U); dhe
 - (d) ajo ka interesa pronësie në formën e kapitalit ose interesa të ngjashme (shiko paragrafët B85V-B85W).
- Mungesa e njërit prej këtyre karakteristikave tipike jo domosdoshmërisht e skualifikon një njësi ekonomike për të qenë një njësi ekonomike investuese. Një njësi ekonomike investuese e cila nuk ka asnjë nga këto karakteristikat tipike duhet të japë informacione shpjeguese shtesë siç kërkohet nga paragrafi 9A i SNRF 12 *Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike.*
- 29 Në qoftë se faktet dhe rrethanat japin indikatorë që ka ndryshime në një apo më shumë prej këtyre elementëve që përbëjnë përkufizimin e një njësie ekonomike investuese, siç përkufizohet në paragrafin 27, ose sipas karakteristikave tipike të një njësie ekonomike investuese të përkufizuara në paragrafin 28, një shoqëri mëmë do të rivlerësojë nëse ajo është një njësi ekonomike investuese apo jo.
- 30 Një shoqëri mëmë e cila pushon së qeni si njësi ekonomike investuese ose bëhet rishtas një njësi ekonomike investuese, do të marrë parasysh këtë ndryshim në statusin e saj në mënyrë prospektive që nga data në të cilin ndryshimi ka ndodhur (shiko paragrafët B100-B101).

Njësitë ekonomike investuese: përjashtim nga konsolidimi

- 31 Me përjashtim të asaj që përkufizohet në paragrafin 32, një njësi ekonomike investuese nuk duhet të konsolidojë filialet e saj ose të aplikojë SNRF 3 kur ajo merr kontrollin e një njësie tjetër ekonomike. Përkundrazi, një njësi ekonomike investuese duhet të masë një investim në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në përputhje me SNRF 9.¹
- 32 Pavarësisht nga kërkesa në paragrafin 31, nëse një njësi ekonomike investuese ka një filial, i cili nuk është vetë një njësi ekonomike investuese dhe ka për qëllim dhe aktivitet kryesor dhënie të shërbimeve që lidhen me aktivitetet investuese të njësisë ekonomike investuese (shih paragrafët B85C - B85E), ajo do ta konsolidojë këtë filial në përputhje me paragrafët 19-26 të këtij Standardi dhe të aplikojë kërkesat e SNRF 3 për blerjen e çdo filiali të tillë.
- 33 Një shoqëri mëmë e një njësie ekonomike investuese do të konsolidojë të gjitha njësitë ekonomike që kontrollojnë, përfshirë ato të kontrolluara nëpërmjet një filiali njësi ekonomike investuese, përveç rastit kur shoqëria mëmë është vetë një njësi ekonomike investuese.

¹ Paragrafi C7 i SNRF 10 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* thekson "Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon këtë SNRF por akoma nuk aplikon SNRF 9, çdo referencë në këtë SNRF për SNRF 9 duhet të lexohet si një referencë për tek SNK 39 *Instrumentet Financiare - Njohja dhe Vlerësimi*".

Shtojca A

Termet e përkufizuara

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së

pasqyra financiare të konsoliduara	Pasqyra financiare të një grupi në të cilin aktivet, detyrimet, kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të shoqërisë mëmë dhe filialeve të saj janë paraqitur si ato të një njësie të vetme ekonomike.
kontroll i një të investuari	Një investitor kontrollon një të investuar, kur investitori është i ekspozuar apo zotëron të drejta për kthimet e ndryshueshme, nga përfshirja e tij me të investuarin, dhe ka aftësinë të ndikojë në këto kthime përmes fuqisë së tij mbi të investuarin.
marrësi i vendimit	Një njësi ekonomike me të drejta të vendimmarrjes, që është ose njësia kryesore, ose një agjent për palët e tjera.
grup	Një shoqëri mëmë dhe filialet e saj.
njësi ekonomike investuese	Një njësi ekonomike që: - merr fonde nga një ose më shumë investitorë me qëllim që t'u japë këtyre investitorëve shërbime të menaxhimit të investimeve; - angazhohet përpara këtyre investitorëve që qëllimi i biznesit të tij është që të investojë me qëllim përfitimi vetëm nga rritja e vlerës së kapitalit, ose vetëm nga të ardhurat nga investimi, apo nga të dyja bashkë; dhe - mat dhe vlerëson performancën e pothuaj të gjithë investimeve të tij në bazë të vlerës së drejtë.
interes jo kontrollues	Kapitali neto në një filial që nuk i takon një shoqërie mëmë as drejtpërdrejt, as tërthorazi.
shoqëria mëmë	Një njësi ekonomike që kontrollon një apo më shumë njësi ekonomike.
fuqia	Të drejtat ekzistuese që japin aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme .
të drejtat mbrojtëse	Të drejtat e përcaktuara për të mbrojtur interesat e palës që i zotëron këto të drejta, pa i dhënë kësaj pale fuqi mbi njësinë ekonomike me të cilën lidhen këto të drejta.
veprimtari përkatës	Për qëllime të këtij SNRF-je, veprimtaritë e rëndësishme janë veprimtaritë e të investuarit që ndikojnë dukshëm në kthimet e tij.
të drejtat e heqjes	Të drejtat që e privojnë vendimmarrësin nga autoriteti i tij i vendimmarrjes.
filial	Një njësi ekonomike që kontrollohet nga një njësi ekonomike tjetër.

Përkufizimet e termave të mëposhtëm jepen në SNRF 11, SNRF 12 *Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike*, SNK 28 (i ndryshuar në 2011) ose SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura* dhe janë përdorur në këtë SNRF sipas kuptimit të dhënë në SNRF-të ku ato janë përcaktuar:

- pjesëmarrje
- interesi në një njësi tjetër ekonomike
- sipërmarrje e përbashkët
- personeli drejtues kryesor
- palë e lidhur
- influencë e konsiderueshme.

Shtojca B

Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së Ajo përshkruan zbatimin e paragrafëve 1-33 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të SNRF-së.

- B1 Shembujt në këtë shtojcë karakterizojnë situata hipotetike. Edhe pse disa aspekte të shembujve mund të jenë të pranishme në modelet aktuale faktike, kur të zbatohet SNRF 10 do të duhet të vlerësohen të gjitha faktet dhe rrethanat e një modeli të veçantë faktik.

Vlerësimi i kontrollit

- B2 Për të përcaktuar nëse kontrollon një të investuar, një investitor do të vlerësojë nëse ka të gjitha karakteristikat e mëposhtme:
- (a) fuqinë mbi të investuarin;
 - (b) ekspozimin ose të drejtat ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e tij me të investuarin; dhe
 - (c) aftësinë për të përdorur fuqinë e tij mbi të investuarin për të ndikuar në shumën e kthimeve të investitorit.
- B3 Shqyrtimi i faktorëve të mëposhtëm mund të ndihmojë në përcaktimin:
- (a) e qëllimit dhe konceptimit të të investuarit (shih paragrafët B5–B8);
 - (b) cilat janë veprimtaritë e rëndësishme dhe si merren vendimet në lidhje me to (shih paragrafët B11–B13);
 - (c) nëse të drejtat i japin investitorit aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme (shih paragrafët B14–B54);
 - (d) nëse investitori është i ekspozuar ndaj kthimeve të ndryshueshme apo ka të drejta mbi to, nga përfshirja e tij me të investuarin (shih paragrafët B55–B57); dhe
 - (e) nëse investitori ka aftësinë të përdorë fuqinë e tij mbi të investuarin për të ndikuar në shumën e kthimeve të investitorit (shih paragrafët B58–B72).
- B4 Gjatë vlerësimit të kontrollit mbi një të investuar, një investitor do të marrë parasysh natyrën e marrëdhënieve të tij me palët e tjera (shih paragrafët B73–B75).

Qëllimi dhe konceptimi i një të investuari

- B5 Gjatë vlerësimit të kontrollit të një të investuari, një investitor do të marrë parasysh qëllimin dhe konceptimin e të investuarit në mënyrë që të identifikojë veprimtaritë e rëndësishme, mënyrën sesi janë marrë vendimet në lidhje me to, cili ka aftësinë aktuale për të drejtuar këto veprimtari dhe cili merr kthimet nga to.
- B6 Kur merren parasysh qëllimi dhe konceptimi i një të investuari, mund të jetë e qartë se një i investuar kontrollohet me anë të instrumenteve të kapitalit neto, që i japin mbajtësit të drejta proporcionale të votës, të tilla si aksionet e zakonshme tek i investuari. Në këtë rast, në mungesë të marrëveshjeve të tjera që ndryshojnë vendimmarrjen, vlerësimi i kontrollit fokusohet se cila palë, nëse ka, është në gjendje të ushtrojë të drejtën e votës, në mënyrë të mjaftueshme, për të përcaktuar politikat financiare dhe të shfrytëzimit të të investuarit (shih paragrafët B34–B50). Në rastin më të drejtpërdrejtë, investitori që zotëron shumicën e këtyre të drejtave të votës, në mungesë të faktorëve të tjerë, kontrollon të investuarin.
- B7 Në rastet më të ndërlikuara, për të përcaktuar nëse një investitor kontrollon një të investuar, mund të jetë e nevojshme të merren parasysh disa ose të gjithë faktorët e tjerë në paragrafin B3.
- B8 Një i investuar mund të konceptohet në mënyrë që të drejtat e votës të mos jenë faktor dominues në përcaktimin se cili kontrollon të investuarin, si në rastin kur të gjitha të drejtat e votës kanë të bëjnë vetëm me detyrat administrative, ndërsa veprimtaritë e rëndësishme drejtohen me anë të marrëveshjeve kontraktuale. Në raste të tilla, një investitor do të përfshijë në shqyrtimin e qëllimit dhe konceptimit të të investuarit, edhe shqyrtimin e rreziqeve ndaj të cilave i investuari parashikohet të jetë i ekspozuar, rreziqe që parashikohen t'u kalojnë palëve të përfshira me të investuarin, dhe nëse investitori është i ekspozuar ndaj

disa ose të gjitha këtyre rreziqeve. Shqyrtimi i rreziqeve përfshin jo vetëm rrezikun e lidhur me humbjet, por edhe mundësinë për rezultate pozitive.

Fuqia

- B9 Për të patur fuqi mbi një të investuar, një investitor duhet të ketë të drejta ekzistuese që i japin atij aftësinë aktuale të drejtojë veprimtaritë e rëndësishme. Për qëllime të vlerësimit të fuqisë, do të merren parasysh vetëm të drejtat thelbësore dhe të drejtat që nuk janë mbrojtëse (shih paragrafët B22–B28).
- B10 Përcaktimi nëse një investitor ka fuqi varet nga veprimtaritë e rëndësishme, mënyra se si janë marrë vendimet në lidhje me to dhe të drejtat që kanë investitori dhe palët e tjera në lidhje me të investuarin.

Veprimtaritë e rëndësishme dhe drejtimi i tyre

- B11 Për shumë të investuar, një sërë veprimtarish të shfrytëzimit dhe të financimit ndikojnë ndjeshëm në kthimet e tyre. Në varësi të rrethanave, shembuj të veprimtarive që mund të jenë veprimtari të rëndësishme përfshijnë rastet e mëposhtme, edhe pse nuk kufizohen vetëm në to:
- (a) shitja dhe blerja e mallrave ose shërbimeve;
 - (b) administrimi i aktiveve financiare gjatë jetës së tyre (duke përfshirë deri mospagimin);
 - (c) përzgjedhja, blerja apo nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve;
 - (d) kërkimi dhe zhvillimi i produkteve ose proceseve të reja; dhe
 - (e) përcaktimi i një strukture financimi ose sigurimi i financimeve.
- B12 Shembuj të vendimeve rreth veprimtarive të rëndësishme përfshijnë rastet e mëposhtme, edhe pse nuk kufizohen vetëm në to:
- (a) vendosja e sistemeve për vendimet kapitale dhe të shfrytëzimit nga i investuari, duke përfshirë buxhetet; dhe
 - (b) emërimi dhe shpërblymimi i personelit drejtues kryesor të një të investuari, ose caktimi i ofruesve të shërbimeve dhe ndërprerjen e shërbimeve të tyre apo të marrëdhënieve të punësimit me ta.
- B13 Në disa situata, veprimtaritë mund të jenë veprimtari të rëndësishme si përpara, ashtu dhe pasi lind një tërësi rrethanash të veçanta apo ndodh ngjarja. Kur dy ose më shumë investitorë kanë aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme dhe këto veprimtari ndodhin në kohë të ndryshme, investitorët do të përcaktojnë se cili prej tyre është në gjendje të drejtojë veprimtaritë, të cilat ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme tek kthimet e tyre, në përputhje me trajtimin e të drejtave të vendimmarrjes të konkurrentit (shih paragrafin 13). Investitorët do ta rishikojnë këtë vlerësim me kalimin e kohës, nëse faktet rëndësishme apo rrethanat ndryshojnë.

Shembuj të zbatimit

Shembulli 1

Dy investitorë formojnë një të investuar për të zhvilluar dhe tregtuar një produkt mjekësor. Njëri nga investitorët është përgjegjës për marrjen e miratimit nga organi rregullator dhe zhvillimin e produktit mjekësor—kjo përgjegjësi do të thotë të kesh kompetencë të njëanshme për të marrë vendime në lidhje me zhvillimin e produktit dhe marrjen e miratimit nga organi rregullator. Pasi rregullatori ka aprovuar produktin, investitori tjetër do ta prodhojë dhe tregtojë atë—ky investitor ka kompetencën e njëanshme të marrë të gjitha vendimet në lidhje me prodhimin dhe marketingun e projektit. Nëse të gjitha veprimtaritë—zhvillimi dhe marrja e miratimit nga organi rregullator, si dhe prodhimi dhe marketingu i produktit mjekësor—janë veprimtari e rëndësishme, çdo investitor duhet të përcaktojë nëse është në gjendje të drejtojë veprimtaritë që ndikojnë më ndjeshëm në kthimet e të investuarit. Prandaj, çdo investitor kërkohet të ketë parasysh nëse zhvillimi dhe marrja e miratimit nga organi rregullator ose prodhimi dhe marketingu i produktit mjekësor janë veprimtari që ndikojnë më ndjeshëm në kthimet e të investuarit dhe nëse ai është në gjendje t'i drejtojë këto veprimtari. Në përcaktimin se cili ka fuqi, investitorët do të marrin parasysh:

- (a) qëllimin dhe konceptimin e të investuarit;
- (b) faktorët që përcaktojnë marzhin e fitimit, të ardhurat dhe vlerën e të investuarit, si dhe vlerën e produktit mjekësor;
- (c) efektin mbi kthimet e të investuarit, që janë si rezultat i autoritetit të vendimmarrjes nga secili prej investitorëve në lidhje me faktorët në pikën (b); dhe

Shembuj të zbatimit

(d) ekspozimin e investitorëve ndaj kthimeve të ndryshueshme.

Në këtë shembull të veçantë, investitorët, gjithashtu, do të marrin parasysh:

(e) pasigurinë dhe përpjekjet e bëra në marrjen e miratimit nga organi rregullator (duke pasur parasysh të dhënat e investitorit për zhvillimin e suksesshëm të produkteve mjekësore dhe marrjen e miratimit nga organi rregullator); dhe

(f) cili investitor kontrollon produktin mjekësor në një kohë që faza e zhvillimit është realizuar në mënyrë të suksesshme.

Shembulli 2

Një mekanizëm investimi (i investuari) është krijuar dhe financohet me një instrument borxhi, që mbahet nga një investitor (investitor borxhi), dhe instrumente të kapitalit neto, që mbahen nga një numër investitorësh të tjerë. Kësti i kapitalit është caktuar për të mbuluar humbjet e para dhe për të marrë ndonjë kthim të mbetur nga i investuari. Një prej investitorëve të kapitalit neto, që zotëron 30 për qind të kapitalit, është edhe administratori i pasurisë. I investuari përdor të ardhurat e tij për të blerë një portofol aktivesh financiare, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë që ka lidhje me moskryerjen e mundshme të pagesave të principalit dhe të interesit të aktiveve. Transaksioni është bërë për investitorin e borxhit si një investim me ekspozim minimal ndaj rrezikut të kredisë, që ka lidhje me mospagimin e mundshëm të aktiveve në portofol, për shkak të natyrës së këtyre aktiveve dhe ngaqë kësti i kapitalit është përcaktuar të përhithë humbjet e para të të investuarit. Kthimet e të investuarit janë prekur ndjeshëm nga drejtimi i portofolit të aktiveve të tij, ku përfshihen vendimet sipas udhëzimeve të portofolit për zgjedhjen, blerjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe drejtimin e çdo lloji aktiviteti të portofolit në çdo rast mospagimi. Të gjitha këto aktivitete janë të menaxhuara nga administruesi i pasurisë derisa mospagimi arrin një përqindje të caktuar të vlerës së portofolit (p.sh. kur vlera e portofolit është e tillë saqë kësti i kapitalit të të investuarit është konsumuar). Që nga kjo kohë, një administrator i besuar si palë e tretë drejton aktivet në përputhje me udhëzimet e investitorit të borxhit. Drejtimi i portofolit të aktiveve të të investuarit është veprimtari e rëndësishme e të investuarit. Administratori i pasurisë ka aftësinë të drejtojë veprimtaritë e rëndësishme deri sa aktivet e mos paguara arrijnë përqindjen e caktuar të vlerës së portofolit; investitori i borxhit ka aftësinë të drejtojë veprimtaritë e rëndësishme, kur vlera e aktiveve të mos paguara tejkalon këtë përqindje të caktuar të vlerës së portofolit. Administratori i pasurisë dhe investitori i borxhit, secili prej tyre, kërkohet të përcaktojnë nëse janë në gjendje të drejtojnë veprimtaritë që ndikojnë më ndjeshëm në kthimet e të investuarit, duke marrë parasysh qëllimin dhe konceptimin e të investuarit, si dhe ekspozimin e secilës palë ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve.

Të drejtat që i japin fuqi një investitori mbi një të investuar

- B14 Fuqia lind nga të drejtat. Që të ketë fuqi mbi një të investuar, një investitor duhet të ketë të drejta ekzistuese që i japin atij aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme. Të drejtat që mund t'i japin fuqi një investitori mund të ndryshojnë ndërmjet të investuarëve.
- B15 Shembuj të të drejtave, qoftë individualisht apo në kombinim, që mund t'i japin fuqi një investitori, përfshijnë rastet e mëposhtme, edhe pse nuk kufizohen vetëm në to:
- (a) të drejtat në formën e të drejtave të votës (ose të të drejtave potenciale të votës) të një i investuar (shih paragrafët B34–B50);
 - (b) të drejtat për të emëruar, ri caktuar ose hequr anëtarë të personelit drejtues kryesor të një të investuar, që kanë aftësinë të drejtojnë veprimtaritë e rëndësishme;
 - (c) të drejtat për të emëruar ose hequr një njësi tjetër ekonomike që drejton veprimtaritë e rëndësishme;
 - (d) të drejtat për të drejtuar të investuarin të hyjë në transaksione apo të ketë veton për ndonjë ndryshim në to në përfitim të investitorit; dhe
 - (e) të drejta të tjera (të tilla si të drejtat e vendimmarrjes të specifikuar në një kontratë të drejtimit), që i japin zotëruesit aftësinë për të drejtuar veprimtari të rëndësishme.
- B16 Në përgjithësi, kur një i investuar ka një gamë veprimtarish shfrytëzimi dhe financimi, që në mënyrë të ndjeshme ndikojnë në kthimet e të investuarit, dhe kur në mënyrë të vazhdueshme kërkohet një vendimarrje thelbësore në lidhje me këto veprimtari, do të jenë të drejtat e votës dhe të ngjashme me to, qoftë individualisht apo në kombinim me marrëveshjet e tjera, që i japin fuqi një investitori.

- B17 Kur të drejtat e votës nuk mund të kenë një efekt të rëndësishëm në kthimet e një të investuari, si në rastin kur të drejtat e votës kanë të bëjnë vetëm me detyrat administrative dhe marrëveshjet kontraktuale përcaktojnë drejtimin e veprimtarive të rëndësishme, investitori kërkohet të vlerësojë këto marrëveshje kontraktuale për të përcaktuar nëse ka të drejta të mjaftueshme që i japin fuqi mbi të investuarin. Për të përcaktuar nëse një investitor ka të drejta të mjaftueshme që i japin atij fuqi, ai merr parasysh qëllimin dhe konceptimin e të investuarit (shih paragrafët B5–B8) dhe kërkesat në paragrafët B51–B54 së bashku me paragrafët B18–B20.
- B18 Në disa rrethana mund të jetë e vështirë të përcaktohet nëse të drejtat e një investitori janë të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi mbi një të investuar. Në raste të tilla, për të patur mundësi që të bëjë vlerësimin e fuqisë, investitori merr parasysh evidencën nëse ka aftësinë praktike për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme në mënyrë të njëanshme. Vëmendje i'u kushtohet rasteve të mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to. Këto raste, të marra së bashku me të drejtat dhe treguesit në paragrafët B19 dhe B20, mund të sigurojnë një evidencë që të drejtat e investitorit janë të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi mbi të investuarin:
- (a) Investitori, pa qenë nevoja të ketë të drejta kontraktuale, mund të emërojë ose të miratojë personelin drejtues kryesor të të investuarit, që ka aftësinë për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme.
 - (b) Investitori, pa qenë nevoja të ketë të drejta kontraktuale, mund të drejtojë të investuarin për të hyrë në transaksione të rëndësishme apo për të vënë veton ndaj ndonjë ndryshimi në to, për të mirën e investitorit.
 - (c) Investitori mund të dominojë ose procesin e propozimeve për zgjedhjen e anëtarëve të organit qeverisës të të investuarit, ose marrjen e prokurës nga mbajtësit e tjerë të të drejtave të votës.
 - (d) Personeli drejtues kryesor i të investuarit janë palë të lidhura të investitorit (për shembull, shefi ekzekutiv i të investuarit dhe shefi ekzekutiv i investitorit janë i njëjti person).
 - (e) Shumica e anëtarëve të organit qeverisës të të investuarit janë palë të lidhura me investitorin.
- B19 Ndonjëherë mund të ketë tregues se investitori ka një marrëdhënie të veçantë me të investuarin, që tregon se investitori ka më shumë se një interes detyrim mbi të investuarin. Ekzistenca e çdo treguesi të veçantë, ose e një kombinimi të veçantë treguesish, nuk do të thotë se është plotësuar kriteri i fuqisë. Megjithatë, të pasurit më shumë se një interes detyrim mbi të investuarin mund të tregojë se investitori ka të drejta të tjera të lidhura të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi apo për t'i siguruar një evidencë për ekzistencën e fuqisë mbi një të investuar. Për shembull, rastet në vijim tregojnë që investitori ka më shumë se një interes detyrim mbi të investuarin dhe, në kombinim me të drejta të tjera, një gjë e tillë mund të dëshmojë për fuqinë:
- (a) Personeli drejtues kryesor i të investuarit, që ka aftësinë të drejtojë veprimtaritë e rëndësishme, përbëhet nga punonjës aktualë ose të mëparshëm të investitorit.
 - (b) Operacionet e të investuarit janë të varura nga investitori, të tilla si në situatat e mëposhtme:
 - (i) I investuari varet nga investitori për të financuar një pjesë të konsiderueshme të operacioneve të tij.
 - (ii) Investitori garanton një pjesë të konsiderueshme të detyrimeve të të investuarit.
 - (iii) I investuari varet nga investitori për shërbime kryesore, teknologji, furnizime apo materiale kryesore.
 - (iv) Investitori kontrollon aktive të tilla si licencat ose markat tregtare që janë kritike për operacionet e të investuarit.
 - (v) I investuari varet nga investitori për personelin drejtues kryesor, si në rastin kur personeli i investitorit ka njohuri të specializuara për operacionet e të investuarit.
 - (c) Një pjesë e rëndësishme e veprimtarive të të investuarit ose përfshijnë, ose janë kryer në emër të investitorit.
 - (d) Ekspozimi i investitorit ose të drejtat për kthimet nga përfshirja e tij me të investuarin janë në mënyrë disproporcionale më të mëdha se të drejtat e tij të votës ose të drejtat e tjera të ngjashme. Për shembull, mund të jetë një situatë në të cilën një investitor ka të drejtën ose është i ekspozuar ndaj më shumë se gjysmës së kthimeve të të investuarit, por zotëron më pak se gjysma e të drejtave të votës së tij.
- B20 Sa më të mëdha të jenë ekspozimi apo të drejtat e një investitori ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve, nga përfshirja e tij me një të investuar, aq më e madhe është nxitja e investitorit për të patur të drejta të mjaftueshme që i japin fuqi. Prandaj, të paturit e një ekspozimi të madh ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve është një tregues se investitori mund të ketë fuqi. Megjithatë, shkalla e ekspozimit të investitorit, në vetvete, nuk përcakton nëse një investitor ka fuqi mbi të investuarin.

- B21 Kur faktorët e përcaktuar në paragrafin B18 dhe treguesit e përcaktuar në paragrafët B19 dhe B20 trajtohen së bashku me të drejtat e një investitori, do t'i jepet më tepër rëndësi evidencës së fuqisë, të përshkruar në paragrafin B18.

Të drejtat thelbësore

- B22 Një investitor, në vlerësimin nëse ka fuqi, merr parasysh vetëm të drejtat thelbësore që lidhen me një të investuar (zotëruar nga investitori dhe të tjerët). Që një e drejtë të jetë thelbësore, zotëruesi duhet të ketë aftësinë praktike për ta ushtruar këtë të drejtë.
- B23 Përcaktimi nëse të drejtat janë thelbësore kërkon gjykim, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat. Faktorët që merren parasysh për të bërë këtë përcaktim, por pa qenë të kufizuar vetëm në ta, përfshijnë:
- (a) Nëse ka ndonjë pengesë (ekonomike ose çfarëdo tjetër) që e pengojnë zotëruenin (apo zotëruetit) për ushtrimin e të drejtave. Shembuj të pengesave të tilla përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to:
 - (i) gjoha financiare dhe stimuj që do të ndalonin (ose frenonin) zotëruenin nga ushtrimi i të drejtave të tij.
 - (ii) një çmim i ushtrimit ose i konvertimit, që krijon një pengesë financiare, që do ta ndalonte (ose frenonte) zotëruenin nga ushtrimi i të drejtave të tij.
 - (iii) afatet dhe kushtet që e bëjnë të pamundur ushtrimin e të drejtave, për shembull, kushtet që kufizojnë tepër kohën e ushtrimit të tyre.
 - (iv) mungesa e një mekanizmi të qartë, të arsyeshëm në dokumentet themeltare të një të investuari ose në ligjet apo rregulloret e zbatueshme që do ta lejonin zotëruenin të ushtronte të drejtat e veta.
 - (v) paafësia e zotëruetit të të drejtave për të marrë informacionin e nevojshëm, që të ushtrojë të drejtat e veta.
 - (vi) pengesat ose stimujt operacionale që do të ndalonin (ose frenonin) zotëruenin nga ushtrimi i të drejtave të tij (p.sh. mungesa e drejtuesve të tjerë që duan, ose janë në gjendje të ofrojnë shërbime të specializuara apo të ofrojnë shërbime dhe të pranojnë interesat të tjera të mbajtura nga drejtuesi në detyrë).
 - (vii) kërkesat ligjore ose rregullatore që ndalojnë zotëruenin nga ushtrimi i të drejtave të tij (p.sh. kur një investitor i huaj është i ndaluar të ushtrojë të drejtat e tij).
 - (b) Kur ushtrimi i të drejtave kërkon marrëveshje me më shumë se një palë, ose kur të drejtat zotërohen nga më shumë se një palë, nëse ka një mekanizëm që i pajis këto palë me aftësinë praktike për të ushtruar të drejtat e tyre në mënyrë kolektive, nëse ata zgjedhin të veprojnë kështu. Mungesa e një mekanizmi të tillë është një tregues se të drejtat nuk mund të jenë thelbësore. Sa më shumë palë kërkohet të bien dakord për të ushtruar të drejtat, aq më pak ka të ngjarë që këto të drejta të jenë thelbësore. Megjithatë, një bord i drejtorëve, anëtarët e të cilit janë të pavarur nga marrësi i vendimit, mund të shërbejë si një mekanizëm për investitorët e shumtë që të veprojnë kolektivisht në ushtrimin e të drejtave të tyre. Prandaj, të drejtat për heqje, që janë të zbatueshme nga një bord i pavarur i drejtorëve, kanë më shumë gjasa të jenë thelbësore se në rastin kur të njëjtat të drejta do të ushtroheshin individualisht nga një numër i madh investitorësh.
 - (c) Nëse pala ose palët, që zotërojnë të drejtat, do të përfitonin nga ushtrimi i këtyre të drejtave. Për shembull, zotëruesi i të drejtave potenciale të votës mbi një të investuar (shih paragrafët B47–B50) do të marrë parasysh çmimin e ushtrimit ose të konvertimit të instrumentit. Termat dhe kushtet e të drejtave potenciale të votës kanë më shumë gjasa të jenë thelbësore kur instrumenti është në mjete monetare ose investitori do të përfitonte për arsye të tjera (p.sh. duke realizuar sinergji midis investitorit dhe të investuarit) nga ushtrimi ose konvertimi i instrumentit.
- B24 Për të qenë thelbësore, të drejtat duhet, gjithashtu, të jenë të ushtrueshme kur kërkohet të merren vendime në lidhje me drejtimin e veprimtarive e rëndësishme. Zakonisht, që të drejtat të jenë thelbësore duhet të ushtrohen aktualisht. Megjithatë, ndonjëherë të drejtat mund të jenë thelbësore, edhe pse ato nuk ushtrohen aktualisht.

Shembuj të zbatimit

Shembulli 3

I investuari bën mbledhje vjetore të aksionarëve në të cilat merren vendimet për të drejtuar veprimtaritë e

Shembuj të zbatimit

rëndësishme. Mbledhja e ardhshme e aksionarëve është parashikuar pas tetë muajsh. Megjithatë, aksionarët që individualisht ose kolektivisht zotërojnë të paktën 5 për qind të të drejtave të votës mund të kërkojnë të bëhet një mbledhje e veçantë për të ndryshuar politikat ekzistuese mbi veprimtaritë e rëndësishme, por bërja e një kërkesë për të njoftuar aksionarët e tjerë do të thotë se ky takim nuk mund të mbahet për të paktën 30 ditë. Politikat mbi veprimtaritë e rëndësishme mund të ndryshohen vetëm në mbledhjet e veçanta ose të planifikuara të aksionarëve. Kjo përfshin miratimin e shitjeve materiale të aktiveve, si dhe kryerjen ose nxjerrjen jashtë përdorimit të investimeve të rëndësishme.

Modeli faktik i mësipërm vlen për shembujt 3A-3D të përshkruara më poshtë. Çdo shembull është konsideruar si shembull i veçantë.

Shembull 3A

Një investitor zotëron shumicën e të drejtave të votës mbi të investuarin. Të drejtat e votës të investitorit janë thelbësore, sepse ai është në gjendje të marrë vendime në lidhje me drejtimin e veprimtarive të rëndësishme, kur është e nevojshme të bëhet një gjë e tillë. Fakti se duhen 30 ditë para se investitori të ushtrojë të drejtat e tij të votës, nuk e pengon atë të ketë aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme nga momenti që ai është aksion mbajtës.

Shembulli 3B

Një investitor është palë në një kontratë të ardhshme për të blerë shumicën e aksioneve në të investuarin. Data e shlyerjes e kontratës së ardhshme është në 25 ditë. Aksionarët ekzistues nuk janë në gjendje të ndryshojnë politikat ekzistuese mbi veprimtaritë e rëndësishme për shkak se një takim i veçantë nuk mund të mbahet për të paktën 30 ditë, moment në të cilin kontrata e ardhshme do të jetë shlyer. Kështu, investitori zotëron të drejta që janë në thelb të njëjta me ato të aksionarit kryesor në shembull 3A më lart (d.m.th investitori që zotëron kontratën e ardhshme mund të marrë vendime në lidhje me drejtimin e veprimtarive të rëndësishme, kur është e nevojshme të bëhet një gjë e tillë). Kontrata e ardhshme e investitorit është një e drejtë thelbësore, që i jep investitorit aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme përpara se kontrata e ardhshme të jetë shlyer.

Shembull 3C

Një investitor ka një opsjon thelbësor për të blerë shumicën e aksioneve të të investuarit, që është i ushtrueshëm në 25 ditë dhe është plotësisht në mjete monetare. I njëjti përfundim do të arrihet si në shembull 3B.

Shembull 3D

Një investitor është palë në një kontratë të ardhshme për të blerë shumicën e aksioneve të të investuarit, pa të drejta të tjera të lidhura mbi të investuarin. Data e shlyerjes e kontratës së ardhshme është në gjashtë muaj. Në dallim nga shembujt e mësipërm, investitori nuk ka aftësinë aktuale të drejtojë veprimtaritë e rëndësishme. Aksionarët ekzistues kanë aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme, sepse ata mund të ndryshojnë politikat ekzistuese mbi to përpara se kontrata të jetë shlyer.

- B25 Të drejtat thelbësore të ushtrueshme nga palët e tjera mund ta ndalojnë një investitor të kontrollojë të investuarin me të cilin këto të drejta lidhen. Këto të drejta thelbësore nuk kërkojnë që zotëruesi të ketë aftësinë të ndërmarrë vendime. Për sa kohë që të drejtat nuk janë thjesht mbrojtëse (shih paragrafët B26–B28), të drejtat thelbësore të zotëruara nga palët e tjera mund ta ndalojnë investitorin të kontrollojë të investuarin edhe në qoftë se të drejtat i japin zotëruesit vetëm aftësinë aktuale për të miratuar ose bllokuar vendime që lidhen me veprimtaritë e rëndësishme.

Të drejtat mbrojtëse

- B26 Në vlerësimin, nëse të drejtat i japin fuqi një investitori mbi një të investuar, investitori do të vlerësojë nëse të drejtat e tij, dhe të drejtat e zotëruara nga të tjerët, janë të drejta mbrojtëse. Të drejtat mbrojtëse kanë të bëjnë me ndryshimet thelbësore në veprimtaritë e një të investuari ose zbatohen në rrethana të jashtëzakonshme. Megjithatë, jo të gjitha të drejtat, që zbatohen në rrethana të jashtëzakonshme ose janë të lidhura me ngjarje eventuale, janë mbrojtëse (shih paragrafët B13 dhe B53).
- B27 Meqë të drejtat mbrojtëse janë të përcaktuara për të mbrojtur interesat e zotëruesit të tyre, pa i dhënë fuqi kësaj pale mbi të investuarin, me të cilin janë të lidhura këto të drejta, një investitor që zotëron vetëm të

drejta mbrojtëse nuk mund të ketë fuqi ose të ndalojë një palë tjetër nga të paturit fuqi mbi një të investuar (shih paragrafin 14).

- B28 Shembujt e të drejtave mbrojtëse përfshijnë rastet e mëposhtme, edhe pse nuk kufizohen vetëm në to:
- (a) e drejta e një huadhënësi për të kufizuar një huamarrës nga ndërmarrja e veprimtarive që mund të ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme rrezikun e kredisë të huamarrësit në dëm të huadhënësit.
 - (b) të drejtën e një pale, që zotëron një interes jo-kontrollues në një të investuar, për të miratuar shpenzime kapitale më të mëdha seç kërkohet në rrjedhën e zakonshme të biznesit, ose për të miratuar emetimin e instrumenteve të kapitalit apo borxhit.
 - (c) të drejtën e një huadhënësi për të konfiskuar aktivet e një huamarrësi, në qoftë se huamarrësi nuk përmbush kushtet e specifikuar të ri pagimit të huas.

Franshizat

- B29 Një marrëveshje franshizë, në të cilën i investuari është i franshizuari, shpesh i jep franshizuesit të drejta që janë caktuar për të mbrojtur markën e franshizës. Marrëveshjet franshizë, në mënyrë tipike, i japin franshizuesit disa të drejta për të marrë vendime në lidhje me operacionet e të franshizuarit.
- B30 Në përgjithësi, të drejtat e franshizuesit nuk kufizojnë aftësinë e palëve, përveç rastit kur franshizuesi merr vendime që kanë një efekt të rëndësishëm në kthimet e të franshizuarit. Të drejtat që franshizuesi zotëron në një marrëveshje franshizë nuk është e thënë t'i japin atij aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë, që në mënyrë të ndjeshme, ndikojnë në kthimet e të franshizuarit.
- B31 Është e nevojshme të bëhet dallimi në mes të paturit aftësi aktuale për të marrë vendime që ndikojnë ndjeshëm në kthimet e të franshizuarit dhe të paturit aftësi për të marrë vendime që mbrojnë markën e franshizës. Franshizuesi nuk ka fuqi mbi të franshizuarin, nëse palët e tjera kanë të drejta ekzistuese që u japin atyre aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtari të rëndësishme të franshizës.
- B32 Me hyrjen në marrëveshje franshizë, i franshizuari ka marrë një vendim të njëanshëm për të operuar biznesin e tij në përputhje me kushtet e marrëveshjes franshizë, por për llogari të vet.
- B33 Kontrolli mbi vendime të tilla themelore, si forma ligjore e të franshizuarit dhe struktura e tij e financimit, mund të përcaktohet nga palë përveç franshizuesit dhe mund të ndikojë ndjeshëm në kthimet e të franshizuarit. Sa më i ulët të jetë niveli i mbështetjes financiare që jepet nga franshizuesi dhe sa më i ulët ekspozimi i franshizuesit ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga i franshizuari, aq më tepër ka gjasa që franshizuesi zotëron vetëm të drejta mbrojtëse.

Të drejtat e votës

- B34 Shpesh një investitor ka aftësinë aktuale, nëpërmjet të drejtave të votës ose të ngjashme me to, për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme. Një investitor merr parasysh kërkesat në këtë seksion (paragrafët B35–B50), nëse veprimtaritë e rëndësishme të një të investuari janë të drejtuar me anë të të drejtave të votës.

Fuqia me shumicën e të drejtave të votës

- B35 Një investitor, që zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votës të një të investuari, ka fuqi në situatat e mëposhtme, me përjashtim të rastit kur zbatohen paragrafi B36 ose paragrafi B37:
- (a) veprimtaritë e rëndësishme drejtohen nga një votë e zotëruesit të shumicës së të drejtave të votës, ose
 - (b) shumica e anëtarëve të organit qeverisës, që drejton veprimtaritë e rëndësishme, janë emëruar me një votë të zotëruesit të shumicës së të drejtave të votës.

Shumica e të drejtave të votës, por pa patur fuqi

- B36 Për një investitor që zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votës të një të investuari, që të ketë fuqi mbi të, të drejtat e votës të investitorit duhet të jenë thelbësore, në përputhje me paragrafët B22–B25, dhe duhet t'i japin investitorit aftësinë aktuale për të drejtuar e veprimtaritë e rëndësishme, të cilat shpesh janë si rezultat i përcaktimit të politikave operative dhe të financimit. Nëse një njësi ekonomike zotëron të drejta ekzistuese, që i japin kësaj njësie të drejtën të drejtojë veprimtaritë e rëndësishme, dhe që njësi nuk është një agjent i investitorit, investitori nuk ka fuqi mbi të investuarin.
- B37 Një investitor nuk ka fuqi mbi një të investuar, edhe pse investitori zotëron shumicën e të drejtave të votës tek i investuari, kur këto të drejta të votës nuk janë thelbësore. Për shembull, një investitor që ka më shumë

se gjysmën e të drejtave të votës të një i investuar nuk mund të ketë fuqi nëse veprimtaritë e rëndësishme janë subjekt i drejtimit nga një qeveri, gjykatë, administrator, administrator i përkohshëm, likuidator ose rregullator.

Fuqia pa patur një shumicë të të drejtave të votës

- B38 Një investitor mund të ketë fuqi edhe në qoftë se ai zotëron më pak se një shumicë të drejtash të votës të një i investuar. Një investitor mund të ketë fuqi duke zotëruar më pak se shumica e të drejtave të votës të një të investuari, për shembull, nëpërmjet:
- (a) një marrëveshje kontraktuale midis investitorit dhe zotëruesve të tjerë të votave (shih paragrafin B39);
 - (b) të drejtat që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera kontraktuale (shih paragrafin B40);
 - (c) të drejtat e votës të investitorit (shih paragrafët B41–B45);
 - (d) të drejtat potenciale të votës (shih paragrafët B47–B50); ose
 - (e) një kombinim i pikave (a)–(d).

Marrëveshja kontraktuale me zotëruesit e tjerë të votave

- B39 Një marrëveshje kontraktuale ndërmjet një investitori dhe zotëruesve të tjerë të votave mund t'i japë investitorit të drejtën të ushtrojë të drejtën e votës, në mënyrë të mjaftueshme, për t'i dhënë fuqi, atij, edhe nëse investitori nuk ka të drejtë vote të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi pa marrëveshje kontraktuale. Megjithatë, një marrëveshje kontraktuale mund të sigurojë që investitori t'i udhëheqë zotëruesit e tjerë të votës se si të votojnë, që t'i japin mundësi atij të marrë vendime në lidhje me veprimtaritë rëndësishme.

Të drejtat nga marrëveshjet e tjera kontraktuale

- B40 Të drejtat e tjera të vendimmarrjes, në kombinim me të drejtat e votës, mund t'i japin investitorit aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë rëndësishme. Për shembull, të drejtat e specifikuar në një marrëveshje kontraktuale në kombinim me të drejtat e votës mund të jenë mjaftueshëm për t'i dhënë një investitori aftësinë aktuale për të drejtuar proceset e prodhimit të një të investuari apo për të drejtuar veprimtari të tjera të shfrytëzimit ose financimit të një të investuari që në mënyrë të ndjeshme ndikojnë në kthimet e të investuarit. Megjithatë, në mungesë të çdo të drejtash të tjera, varësia ekonomike e një të investuari nga investitori (të tilla si marrëdhëniet e një furnizuesi me konsumatorin kryesor të tij) nuk e bën investitorin të ketë fuqi mbi të investuarin.

Të drejtat e votës së investitorit

- B41 Një investitor, me më pak se shumicën e të drejtave të votës, zotëron të drejta që janë të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi, kur ai ka aftësinë praktike për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme në mënyrë të njëanshme.
- B42 Në vlerësimin nëse të drejtat e votës të një investitori janë të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi, një investitor merr parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat, duke përfshirë:
- (a) madhësinë e zotërimit të të drejtave të votës nga ana e investitorit në krahasim me madhësinë dhe shpërndarjen e zotërimeve të zotëruesve të tjerë të votave, duke vënë në dukje se:
 - (i) sa më shumë të drejta vote të zotërojnë investitori, aq më shumë ka të ngjarë që ai të ketë të drejta ekzistuese që i japin atij aftësi aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme;
 - (ii) sa më shumë të drejta të votës zotëron një investitor në krahasim me zotëruesit e tjerë të votave, aq më shumë ka gjasa që investitori të ketë të drejta ekzistuese që i japin atij aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtari e rëndësishme;
 - (iii) sa më shumë palë do të duheshin të vepronin së bashku për t'iu kundërvënë me vota investitorit, aq më shumë ka të ngjarë që investitori të ketë të drejta ekzistuese që i japin atij aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtari të rëndësishme;
 - (b) të drejtat potenciale të votës zotërohen nga investitori, zotëruesit e tjerë të votës ose palët e tjera (shih paragrafët B47–B50);
 - (c) të drejtat që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera kontraktuale (shih paragrafin B40); dhe

- (d) çfarëdo faktesh dhe rrethanash shtesë që tregojnë se investitori ka ose nuk ka aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme, në kohën që kërkohet të merren vendime, duke përfshirë sistemet e votimit në mbledhjet e aksionarëve të mëparshëm.

B43 Kur drejtimi i veprimtarive të rëndësishme përcaktohet me votën e shumicës dhe një investitor zotëron të drejta, në mënyrë të konsiderueshme më shumë se çdo zotërues tjetër ose grup i organizuar zotëruesish, dhe aksionmbajtësit e tjerë kanë një shpërndarje të gjerë, mund të jetë e qartë që investitori ka fuqi mbi të investuarin, pasi janë marrë parasysh vetëm faktorët e renditur në paragrafin B42(a)–(c).

Shembuj të zbatimit

Shembulli 4

Një investitor blen 48 për qind të të drejtave të votës të një të investuari. Të drejtat e mbetura të votës zotërohen nga mijëra aksionarë, ku asnjëri prej tyre, në mënyrë individuale, nuk zotëron më shumë se 1 për qind të të drejtave të votës. Asnjë nga aksionarët nuk ka ndonjë marrëveshje për t'u konsultuar me ndonjë nga të tjerët apo për të marrë vendime kolektive. Gjatë vlerësimit të proporcionit të të drejtave të votës që blen, mbi bazën e madhësisë relative të aksion mbajtësve të tjerë, investitori ka përcaktuar se një interes prej 48 për qind do të ishte i mjaftueshëm për t'i siguruar atij kontrollin. Në këtë rast, në bazë të madhësisë absolute të zotërimit të tij dhe madhësisë relative të aksion mbajtësve të tjerë, investitori arrin në përfundimin se ai ka një interes të mjaftueshëm dominues të votës për të plotësuar kriterin e fuqisë, pa qenë nevoja të merret parasysh çdo evidencë tjetër në lidhje me fuqinë.

Shembulli 5

Investitori A zotëron 40 për qind të të drejtave të votës të një të investuari, ndërsa secili nga dymbëdhjetë investitorët e tjerë zotëron 5 për qind të të drejtave të votës. Një marrëveshje aksion mbajtësish i jep investitorit A të drejtën të emërojë, shkarkojë dhe të vendosë shpërblimin e drejtimit që është përgjegjës për drejtimin e veprimtarive të rëndësishme. Për të ndryshuar marrëveshjen është e nevojshme dy të tretat e votës së shumicës të aksionarëve. Në këtë rast, investitori A arrin në përfundimin se madhësia absolute e zotërimit të investitorit dhe madhësia relative e aksion mbajtësve të tjerë nuk janë përfundimtare në përcaktimin nëse investitori zotëron të drejta të mjaftueshme për t'i dhënë fuqi. Megjithatë, investitori A konstaton se e drejta e tij kontraktuale për të emëruar, shkarkuar dhe vendosur shpërblimin e drejtimit është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai ka fuqi mbi të investuarin. Fakti që investitori A nuk ka mundur ta ushtrojë këtë të drejtë ose fakti që investitori A është duke e ushtruar të drejtën e tij për të zgjedhur, emëruar ose shkarkuar persona të drejtimit, nuk do të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse investitori A ka fuqi.

B44 Në situata të tjera, mund të jetë e qartë se një investitor nuk ka fuqi pasi të jenë marrë parasysh vetëm faktorët e renditur në paragrafin B42(a)–(c).

Shembuj zbatimi

Shembulli 6

Investitori A zotëron 45 përqind të të drejtave të votës të një të investuari. Dy investitorë të tjerë zotërojnë secili nga 26 për qind të të drejtave të votës të investuari. Të drejtat e mbetura të votës zotërohen nga tre aksionarë të tjerë, secili ka 1 për qind. Nuk ka marrëveshje të tjera që ndikojnë në vendimmarrje. Në këtë rast, madhësia e interesit të investitorit dhe madhësia tij në krahasim me atë të aksion mbajtësve të tjerë janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se investitori A nuk ka fuqi. Vetëm dy investitorët e tjerë do të duhej të bashkëpunonin për të qenë në gjendje të mos lejojnë një investitor të drejtojë veprimtaritë e rëndësishme të të investuarit.

B45 Megjithatë, faktorët e renditur vetëm në paragrafin B42(a)–(c) nuk mund të jenë përfundimtarë. Në qoftë se një investitor, duke konsideruar këta faktorë, nuk e ka të qartë nëse ka fuqi, ai do të marrë parasysh fakte dhe rrethana të tjera, të tilla si nëse aksionarët e tjerë janë detyrime në natyrë, siç demonstron nga sistemi i votimit në mbledhjet e aksionarëve të mëparshëm. Kjo përfshin vlerësimin e faktorëve të përcaktuar në paragrafin B18 dhe treguesve në paragrafët B19 dhe B20. Sa më pak të drejta të zotërojë investitori dhe sa më i vogël numri i palëve që do të duhet të veprojnë së bashku për t'iu kundërvënë investitorit, aq më shumë duhen mbajtur parasysh faktet dhe rrethanat shtesë për të vlerësuar nëse të drejtat e investitorit janë të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi. Kur faktet dhe rrethanat në paragrafët B18–B20 konsiderohen së

bashku me të drejtat e investitorit, do t'i jepet më tepër rëndësi evidencës mbi fuqinë në paragrafin B18, se sa treguesve të fuqisë në paragrafët B19 dhe B20.

Shembuj të zbatimit
Shembulli 7 Një investitor zotëron 45 përqind të të drejtave të votës të një të investuari. Njëmbëdhjetë aksionarë të tjerë zotërojnë secili nga 5 përqind të të drejtave të votës të të investuarit. Asnjë nga aksionarët nuk ka marrëveshje kontraktuale për t'u konsultuar me të tjerë apo për të marrë vendime kolektive. Në këtë rast, madhësia absolute e zotërimit të investitorit dhe madhësia relative vetëm e aksionarëve të tjerë nuk janë përfundimtare në përcaktimin nëse investitori zotëron të drejta të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi mbi të investuarin. Fakte dhe rrethana të tjera do të merreshin parasysh si një evidencë që investitori ka ose nuk ka fuqi. Shembulli 8 Një investitor zotëron 35 përqind të të drejtave të votës të një të investuari. Tre aksionarët e tjerë zotërojnë secili nga 5 përqind të të drejtave të votës të të investuarit. Të drejtat e mbetura zotërohen nga një numër aksionarësh të tjerë, asnjëri prej tyre, në mënyrë individuale, nuk zotëron më shumë se 1 përqind të të drejtave. Asnjë prej aksionarëve nuk ka marrëveshje për t'u konsultuar me të tjerët apo të marrë vendime kolektive. Vendimet në lidhje me veprimtaritë e rëndësishme të të investuarit kërkojnë miratimin me një shumicë votash të mbledhura në mbledhjet përkatëse të aksionarëve –në mbledhjet e fundit të aksionarëve të rëndësishëm janë mbledhur 75 përqind e të drejtave të votës të të investuarit. Në këtë rast, pjesëmarrja aktive e aksionarëve të tjerë në mbledhjet e fundit të aksionarëve tregon se investitori nuk do të kishte aftësinë praktike për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme në mënyrë të njëanshme, pavarësisht nëse investitori ka drejtuar veprimtaritë e rëndësishme meqë një numër i mjaftueshëm i aksionarëve të tjerë votuan në të njëjtën mënyrë si ai.

- B46 Nëse nuk është e qartë që investitori ka fuqi, pasi merren parasysh faktorët e renditur në paragrafin B42(a)–(d), investitori, nuk ka kontroll mbi të investuarin.

Të drejtat potenciale të votës

- B47 Gjatë vlerësimit të kontrollit, një investitor merr parasysh të drejtat e tij potenciale të votës, si dhe të drejtat potenciale të zotëruara nga palët e tjera, për të përcaktuar nëse ai ka fuqi. Të drejtat potenciale të votës janë të drejta për të siguruar të drejtat e votës të një të investuari, të tilla si ato që rrjedhin nga instrumentet e konvertueshme ose opsionet, duke përfshirë kontratat e ardhshme. Këto të drejta potenciale të votës merren parasysh vetëm nëse të drejtat janë thelbësore (shih paragrafët B22–B25).
- B48 Kur gjykohet për të drejtat potenciale të votës, një investitor do të marrë parasysh qëllimin dhe përcaktimin e instrumentit, si dhe qëllimin dhe përcaktimin e çdo përfshirje tjetër që investitori ka me të investuarin. Kjo përfshin një vlerësim të termave të ndryshme dhe kushteve të instrumentit si dhe të pritshmërive të dukshme të investitorit, motivet dhe arsyet për të rënë dakord me këto terma dhe kushte.
- B49 Nëse investitori zotëron edhe të drejta të votës ose të drejta të tjera të vendimmarrjes, që lidhen me veprimtaritë e të investuarit, investitori vlerëson nëse këto të drejta, në kombinim me të drejtat potenciale të votës, i japin atij fuqi.
- B50 Të drejtat potenciale thelbësore të votës vetëm, ose në kombinim me të drejta të tjera, mund t'i japin investitorit aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme. Për shembull, kjo ka të ngjarë të jetë rasti kur një investitor zotëron 40 përqind të të drejtave të votës të një të investuari dhe, në përputhje me paragrafin B23, zotëron të drejtat thelbësore që rrjedhin nga opsionet për të blerë një 20 përqind tjetër të të drejtave të votës.

Shembuj të zbatimit
Shembulli 9 Investitori A zotëron 70 përqind të të drejtave të votës të një të investuari. Investitori B zotëron 30 përqind të të drejtave të votës të të investuarit, si dhe një opsion për të blerë gjysmën e të drejtave të investitorit A. Opsioni është i ushtrueshëm për dy vitet e ardhshme me një çmim të caktuar që është thellësisht pa mjete monetare (dhe pritet të mbetet kështu për këtë periudhë dy-vjeçare). Investitori A është duke i ushtruar të drejtat e tij dhe është duke drejtuar në mënyrë aktive veprimtaritë e rëndësishme të të investuarit. Në këtë

Shembuj të zbatimit

rast, investitori A ka të ngjarë të plotësojë kriterin e fuqisë, sepse ai duket se ka aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme. Megjithatë investitori B ka aktualisht opsione të ushtrueshme për të blerë të drejta shtesë të votës (që, nëse ushtrohen, do t'i jepnin atij një shumicë të drejtash të të investuarit), termat dhe kushtet që lidhen me këto opsione janë të tilla që opsionet nuk konsiderohen si thelbësore.

Shembulli 10

Investitori A dhe dy investitorë të tjerë zotërojnë secili një të tretën e të drejtave të votës të një të investuari. Aktiviteti i biznesit të të investuarit është i lidhur ngushtë me investitorin A. Përveç instrumenteve të kapitalit neto, investitori A ka, gjithashtu, instrumente borxhi që janë të konvertueshme në aksione të zakonshme të të investuarit, në çdo kohë, me një çmim të caktuar që është pa mjete monetare (por jo plotësisht pa mjete monetare). Nëse borxhi konvertohet, investitori A do të zotëronte 60 për qind të të drejtave të votës të të investuarit. Investitori A do të përfitonte nga realizimi i sinergjive, nëse instrumentet e borxhit do të konvertoheshin në aksione të zakonshme. Investitori A ka fuqi mbi të investuarin, sepse ai zotëron të drejtat e votës të të investuarit së bashku me të drejtat potenciale thelbësore të votës që i japin atij aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme.

Fuqia kur të drejtat e votës ose të drejta të ngjashme me to nuk kanë një efekt të rëndësishëm në kthimet e të investuarit

- B51 Në vlerësimin e qëllimit dhe të konceptimit të një të investuari (shih paragrafët B5–B8), një investitor do të marrë në konsideratë përfshirjen dhe vendimet e bëra në fillimet e të investuarit, si pjesë e konceptimit të tij dhe vlerësimit nëse termat e transaksionit dhe karakteristikat e përfshirjes i sigurojnë investitorit të drejtat, që janë të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi. Vetëm të qenurit i përfshirë në konceptimin e një të investuari nuk është e mjaftueshme për t'i siguruar kontrollin investitorit. Megjithatë, përfshirja në konceptim mund të tregojë se investitori ka patur mundësinë të sigurojë të drejta që janë të mjaftueshme për t'i dhënë atij fuqi mbi të investuarin.
- B52 Përveç kësaj, një investitor do të marrë parasysh marrëveshjet kontraktuale të tilla si të drejtat e blerjes, të drejtat e kthimit dhe të drejtat e likuidimit të vendosura në fillimet e të investuarit. Kur këto marrëveshje kontraktuale përfshijnë veprimtari që janë të lidhura ngushtë me të investuarin, atëherë këto veprimtari janë, në thelb, një pjesë integrale e veprimtarive të përgjithshme të të investuarit, edhe pse ato mund të jenë përtej kufijve ligjore të tij. Prandaj, të drejtat e qarta ose të nënkuptuara të vendimmarrjes, të përfshira në marrëveshjet kontraktuale, që janë të lidhura ngushtë me të investuarin, duhet të konsiderohen si veprimtari të rëndësishme gjatë përcaktimit të fuqisë mbi të investuarin.
- B53 Për disa të investuar, veprimtaritë e rëndësishme kryhen vetëm atëherë kur krijohen rrethana ose ndodhin ngjarje të veçanta. I investuari mund të jetë konceptuar në mënyrë të tillë që drejtimi i veprimtarive të tij dhe kthimet e tyre janë të paracaktuara, nëse dhe përderisa linden apo ndodhin këto rrethana ose ngjarje të veçanta. Në këtë rast, vetëm vendimet në lidhje me veprimtaritë e të investuarit, kur krijohen këto rrethana ose ndodhin këto ngjarje, mund të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në kthimet e tij dhe kështu të jenë veprimtari të rëndësishme. Rrethanat apo ngjarjet nuk duhet të kenë ndodhur për shkak të një investitori që ka aftësinë t'i marrë këto vendime për të patur fuqi. Fakti se e drejta për të marrë vendime është e kushtëzuar nga rrethanat që linden apo ngjarja që ndodh, në vetvete, i bëjnë mbrojtëse këto të drejta.

Shembuj të zbatimit**Shembulli 11**

Siç është specifikuar në dokumentet themeluese të tij, i vetmi aktivitet i biznesit i një të investuari është të blejë llogari të arkëtueshme dhe t'u shërbejë atyre në mënyrë të përditshme në emër të investitorëve të tij. Shërbimi mbi bazë ditore përfshin mbledhjen dhe kalimin e pagesave të principalit dhe interesit kur ato kryhen. Me mospagimin e një llogarie të arkëtueshme, i investuari automatikisht ia kthen veçmas atë një investitori, siç është rënë dakord në një marrëveshje të këtij lloji të lidhur në mes investitorit dhe të investuarit. E vetmja veprimtari e rëndësishme është menaxhimi i llogarive të arkëtueshme në rast vonese, sepse kjo është e vetmja veprimtari që mund të ndikojë në mënyrë të ndjeshme në kthimet e të investuarit. Menaxhimi i arkëtimeve para se pagesa të mos bëhet nuk është një veprimtari e rëndësishme, ngaqë nuk kërkon të merren vendime thelbësore që mund të ndikojnë ndjeshëm mbi kthimet e të investuarit – veprimtaritë para mospagimit janë të paracaktuara dhe qëndrojnë vetëm në mbledhjen e flukseve monetare kur ato paguhen dhe kalimin e tyre tek investitorët. Prandaj, vetëm e drejta e investitorëve për të drejtuar aktivitet në rast të vonesave në pagesë duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të veprimtarive të

Shembuj të zbatimit

përgjithshme të të investuarit, që ndikojnë ndjeshëm tek kthimet e tij.

Në këtë shembull, caktimi i të investuarit siguron që investitori ka autoritetin e vendimmarrjes mbi veprimtarinë, që ndikojnë ndjeshëm në kthimet, pikërisht në kohën që kërkohet ky autoritet. Kushtet e marrëveshjes së kthimit janë pjesë përbërëse e transaksionit të përgjithshëm dhe e krijimit të të investuarit. Prandaj, termat e marrëveshjes, së bashku me dokumentet themeltare të të investuarit çojnë në përfundimin se investitori ka fuqi mbi të investuarin, edhe pse investitori ka pronësinë e llogarive të arkëtueshme vetëm në rastin kur ka vonesa në pagesë dhe menaxhon llogaritë e arkëtueshme përtej kufijve ligjore të të investuarit.

Shembulli 12

Aktivet e vetme të një të investuari janë llogaritë e arkëtueshme. Kur është gjykuar për qëllimin dhe konceptimin e të investuarit, është përcaktuar që veprimtaria e vetme e rëndësishme është menaxhimi i llogarive të arkëtueshme deri në rast mospagese. Pala, që ka aftësinë për të menaxhuar mospagimin e llogarive të arkëtueshme, ka fuqi mbi të investuarin, pavarësisht nëse ndonjë nga huamarrësit nuk ka paguar në kohë.

- B54 Një investitor mund të ketë një angazhim të qartë ose të nënkuptuar që të sigurojë se një i investuar vazhdon të veprojë siç është konceptuar. Ky angazhim mund të rrisë ekspozimin e investitorit ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve dhe në këtë mënyrë të nxisë më tej investitorin për të marrë të drejta të mjaftueshme që t'i japin fuqi. Prandaj, një angazhim për të siguruar që një i investuar vepron sikurse është konceptuar mund të jetë një tregues se investitori ka fuqi, por një gjë e tillë as nuk i jep fuqi një investitori, as nuk e pengon një palë tjetër të ketë fuqi.

Ekspozimi ndaj kthimeve të ndryshueshme ose të drejtat mbi to nga një i investuar

- B55 Gjatë vlerësimit nëse një investitor ka kontrollin mbi një të investuar, investitori përcakton nëse është i ekspozuar ndaj kthimeve të ndryshueshme apo zotëron të drejta mbi to, nga përfshirja e tij me të investuarin.
- B56 Kthimet e ndryshueshme janë kthime që nuk janë fikse dhe kanë mundësi të ndryshojnë si rezultat i performancës të një të investuari. Kthimet e ndryshueshme mund të jenë vetëm pozitive, vetëm negative apo njëherësh pozitive dhe negative (shih paragrafin 15). Një investitor vlerëson nëse kthimet nga një i investuar janë të ndryshueshme dhe sa janë të ndryshueshme, në bazë të përmbajtjes së marrëveshjes dhe pavarësisht nga forma ligjore e kthimeve. Për shembull, një investitor mund të zotërojë një obligacion me pagesa interesi fikse. Pagesat fikse të interesit janë kthime të ndryshueshme për qëllime të këtij SNRF-je, sepse ato janë subjekt i rrezikut të mospagimit dhe e ekspozojnë investitorin ndaj rrezikut të kredisë të emetuesit të obligacionit. Madhësia e ndryshueshmërisë (d.m.th sa të ndryshueshme janë këto kthime) varet nga rreziku i kredisë së obligacionit. Në mënyrë të ngjashme, tarifat fikse të performancës për administrimin e aktiveve të një të investuari janë kthime të ndryshueshme, sepse ato e ekspozojnë investitorin ndaj rrezikut të performancës të të investuarit. Madhësia e ndryshueshmërisë varet nga aftësia e të investuarit për të gjeneruar ardhura të mjaftueshme për të paguar tarifën.
- B57 Shembuj të kthimeve përfshijnë:
- (a) dividendët, shpërndarjet e tjera të përfitimeve ekonomike nga një i investuar (p.sh. interesi nga letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga ana e të investuarit) dhe ndryshimet në vlerën e investimeve të investitorit tek ky i investuar.
 - (b) shpërblimi për aktive apo detyrime shërbimi të të investuarit, tarifat dhe ekspozimi ndaj humbjes nga dhënie kredie ose mbështetje likuiditeti, interesat e mbetur në aktivet e të investuarit dhe detyrimet nga likuidimi i këtij të investuari, përfitimet tatimore, si dhe qasja që një investitor ka në likuiditetin e ardhshëm nga përfshirja e tij me një të investuar.
 - (c) kthimet që nuk janë të vlefshme për zotëruesit e tjerë të interesit. Për shembull, një investitor mund të përdorë aktivet e tij në kombinim me aktivet e të investuarit, si në rastin e kombinimit të funksioneve të shfrytëzimit për të arritur ekonomitë e shkallës, kursimet në kosto, të siguruarit nga të tjerë të produkteve të rralla, mundësisë për të hyrë ose përdorur njohuritë e zotëruara ose kufizimit të disa operacioneve apo aktiveve, për të rritur vlerën e aktiveve të tjera të investitorit.

Lidhja midis fuqisë dhe kthimeve

Fuqia e deleguar

- B58 Kur një investitor me të drejta të vendimmarrjes (një vendimmarrës) vlerëson nëse ai kontrollon një të investuar, atëherë do të përcaktojë nëse ai është kryesori apo një agjent. Një investitor do të përcaktojë nëse një njësi tjetër ekonomike, me të drejta të vendimmarrjes, është duke vepruar si një agjent për investitorin. Një agjent është palë e angazhuar kryesisht për të vepruar në emër dhe për të mirën e një pale apo palëve tjetër (njësia kryesore ose njësitë kryesore) dhe për këtë arsye nuk ka kontroll mbi të investuarin, kur ushtron autoritetin e tij të vendimmarrjes (shih paragrafët 17 dhe 18). Kështu, nganjëherë fuqia e një njësie kryesore mund të zotërohet dhe të ushtrohet nga një agjent, por në emër të saj. Një vendimmarrës nuk është një agjent, thjesht për faktin se palët e tjera mund të përfitojnë nga vendimet që ai merr.
- B59 Një investitor mund t'ia delegojë autoritetin e tij të vendimmarrjes një agjenti në disa çështje të caktuara apo në të gjitha veprimtaritë e rëndësishme. Gjatë vlerësimit nëse ka kontroll mbi një të investuar, investitori duhet të trajtojë të drejtat e vendimmarrjes, të deleguara tek agjenti i tij, si të mbajtura drejtpërdrejt nga vetë ai. Në situata kur ka më shumë se një njësi kryesore, secila prej tyre do të vlerësojë nëse ka fuqi mbi të investuarin duke marrë parasysh kërkesat në paragrafët B5–B54. Paragrafët B60–B72 japin udhëzime në përcaktimin nëse një vendimmarrës është një agjent apo kryesori.
- B60 Në përcaktimin nëse është një agjent, një vendimmarrës do të marrë në konsideratë marrëdhëniet e përgjithshme midis atij vetë dhe të investuarit dhe palëve të tjera të përfshira me të investuarin, në veçanti të gjithë faktorët në vijim:
- (a) shtrirjen e autoritetit të vendimmarrjes së tij mbi të investuarin (paragrafët B62 dhe B63).
 - (b) të drejtat që zotërohen nga palët e tjera (paragrafët B64–B67).
 - (c) shpërblimin që i takon në përputhje me marrëveshjen (ve) e shpërblimit (paragrafët B68–B70).
 - (d) ekspozimin e vendimmarrësit ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga interesat e tjera që zotëron te i investuari (paragrafët B71 dhe B72).
- Secilit prej faktorëve do t'i jepet rëndësi e ndryshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të veçanta.
- B61 Përcaktimi nëse një vendimmarrës është një agjent kërkon një vlerësim të të gjithë faktorëve të përmendur në paragrafin B60, përveçse një palë e vetme zotëron të drejtat thelbësore për të hequr vendimmarrësin (të drejtat e heqjes) dhe mund ta heqë atë pa ndonjë arsye (shih paragrafin B65).

Shtrirja e autoritetit të vendimmarrjes

- B62 Shtrirja e autoritetit të vendimmarrjes vlerësohet duke marrë në konsideratë:
- (a) veprimtaritë që janë të lejuara në bazë të marrëveshjes (marrëveshjeve) së vendimmarrjes dhe të specifikuar me ligj, dhe
 - (b) gjykimit se vendimmarrësi ka qenë kur janë marrë vendimet në lidhje me këto veprimtari.
- B63 Një vendimmarrës do të marrë në konsideratë qëllimin dhe konceptimin e të investuarit, rreziqet ndaj të cilave i investuari është konceptuar të jetë i ekspozuar, rreziqet që planifikohen t'u kalojnë palëve të përfshira dhe nivelin e përfshirjes që vendimmarrësi ka në konceptimin e një të investuari. Për shembull, nëse një vendimmarrës është përfshirë ndjeshëm në konceptimin e të investuarit (duke përfshirë edhe përcaktimin e fushës së autoritetit të vendimmarrjes), kjo përfshirje mund të tregojë se vendimmarrësi ka patur mundësi dhe nxitje të fitojë të drejtat që i sigurojnë vendimmarrësit aftësinë për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme.

Të drejtat e zotëruara nga palët e tjera

- B64 Të drejtat thelbësore, që zotërohen nga palët e tjera, mund të ndikojnë në aftësinë e vendimmarrësit për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme të një të investuari. Të drejtat thelbësore të heqjes ose të drejta të tjera mund të tregojnë se vendimmarrësi është një agjent.
- B65 Kur një palë e vetme zotëron të drejtat thelbësore të heqjes dhe mund ta heqë vendim marrësin pa arsye, duke u marrë si një rast i veçantë, një gjë e tillë është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se vendimmarrësi është një agjent. Nëse më shumë se njëra palë zotëron të drejta të tilla (dhe asnjë palë në mënyrë individuale nuk mund të heqë vendimmarrësin pa rënë dakord me palët e tjera), këto të drejta, në mënyrë të veçantë, nuk janë përfundimtare në përcaktimin se një vendimmarrës vepron kryesisht në emër dhe për dobi të të tjerëve. Përveç kësaj, sa më i madh të jetë numri i palëve që kërkojnë për të vepruar së

bashku në ushtrimin e të drejtave për të hequr një vendimmarrës, dhe sa më e madhe të jetë madhësia e interesave të tjera ekonomike (pra shpërblimi dhe interesat e tjera) të vendimmarrësit, si dhe ndryshueshmëria e lidhur me to, aq më pak rëndësi do t'i kushtohet këtij faktori.

- B66 Të drejtat thelbësore që zotërohen nga palët e tjera, që kufizojnë lirinë e një vendimmarrësi, do të konsiderohen në mënyrë të ngjashme me të drejtat e heqjes, kur të vlerësohet nëse vendimmarrësi është një agjent. Për shembull, një vendimmarrës, që kërkohet të marrë miratimin nga një numër i vogël palësh të tjera për veprimet e tij, në përgjithësi, është një agjent. (Shih paragrafët B22–B25 për udhëzim shtesë mbi të drejtat dhe nëse ato janë thelbësore.)
- B67 Shqyrtimi i të drejtave të zotëruara nga palët e tjera do të përfshijë një vlerësim të çfarëdo të drejtash që ushtrohen nga bordi i drejtorëve (ose organ tjetër qeverisës) të një të investuari dhe të efektit të tyre në autoritetin e vendimmarrjes (shih paragrafin B23(b)).

Shpërblimi

- B68 Sa më e madhe të jetë madhësia dhe ndryshueshmëria e lidhur me shpërblimin e vendimmarrësit, në krahasim me kthimet e pritshme nga veprimtaritë e të investuarit, aq më shumë gjasa ka që vendimmarrësi të jetë kryesori.
- B69 Në përcaktimin nëse është një kryesor ose një agjent, vendimmarrësi do të marrë gjithashtu në konsideratë nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme:
- (a) Shpërblimi i vendimmarrësit është në përpjesëtim të drejtë me shërbimet e ofruara.
 - (b) Marrëveshja e shpërblimit përfshin vetëm afatet, kushtet ose shumat që zakonisht paraqiten në marrëveshjet për shërbime të ngjashme dhe shkallën e aftësive të negociuara në bazë palësh të palidhura me njëra-tjetrën.
- B70 Një vendimmarrës nuk mund të jetë një agjent po të mos ekzistojnë kushtet e vendosura në paragrafin B69(a) dhe (b). Megjithatë, plotësimi i këtyre kushteve në mënyrë të veçantë nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se një vendimmarrës është një agjent.

Ekspozimi ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga interesa të tjera

- B71 Një vendimmarrës që zotëron interesa të tjera të një i investuar (p.sh. investimet të një i investuar ose jep garanci në lidhje me performancën e të investuarit), do të marrë parasysh ekspozimin ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga këto interesa në vlerësimin nëse ai është një agjent. Zotërimi i interesave të tjera të një i investuar tregon se vendimmarrësi mund të jetë një kryesor.
- B72 Në vlerësimin e ekspozimit të tij ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga interesat e tjera të i investuari, një vendimmarrës do të marrë parasysh në vijim:
- (a) sa më e madhe është madhësia dhe ndryshueshmëria e lidhur me interesat e tij ekonomike, duke marrë parasysh shpërblimin e vet dhe interesat e tjera në total, aq më shumë ka të ngjarë që vendimmarrësi të jetë një kryesor.
 - (b) nëse ekspozimi i tij ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve është i ndryshëm nga ai e investitorëve të tjerë dhe, nëse është kështu, nëse mund të ndikojë kjo në veprimet e tij. Për shembull, ky mund të jetë rasti kur një vendimmarrës zotëron interesa të varura ose ofron forma të tjera të mbajtjes së aktivitetit si garanci kredie të një i investuar.

Vendimmarrësi do të vlerësojë ekspozimin e tij në krahasim me ndryshueshmërinë totale të kthimeve të të investuarit. Ky vlerësim bëhet kryesisht mbi bazën e kthimeve të pritshme nga veprimtaritë e të investuarit, por nuk do të injorohet ekspozimin maksimal të vendimmarrësit ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve të të investuarit nëpërmjet interesave të tjera që vendimmarrësi zotëron.

Shembuj të zbatimit

Shembulli 13

Një vendimmarrës (drejtuesi i fondit) krijon, tregton dhe drejton një fond të rregulluar, që tregton publikisht, sipas parametrave të përcaktuara ngushtë në mandatin e investimeve, siç kërkohet nga ligjet dhe rregulloret lokale. Fondi blihet nga investitorët si një investim në një portofol të diversifikuar të letrave me vlerë të kapitalit neto të njësisë që tregtojnë publikisht. Brenda parametrave të përcaktuara, drejtuesi i fondit ka liri veprimi në lidhje me aktivitetet të cilat do të investohen. Drejtuesi i fondit ka bërë një investim në fond, proporcionalisht 10 për qind, dhe merr një tarifë të bazuar në treg për shërbimet e tij, të barabartë me 1 për qind të vlerës së aktiveve neto të fondit. Tarifat janë në përpjesëtim me shërbimet e

Shembuj të zbatimit

ofruara. Drejtuesi i fondit nuk ka ndonjë detyrim për të financuar humbjet përtej 10 për qind të investimit. Nuk është e nevojshme që fondi të vendosë dhe nuk ka vendosur një bord të pavarur drejtorësh. Investitorët nuk zotërojnë asnjë të drejtë thelbësore që do të ndikonte në autoritetin e vendimmarrjes së drejtuesit të fondit, por mund të blejë interesat e tyre brenda kufijve të veçantë të përcaktuara nga fondi.

Edhe pse vepron brenda parametrave të përcaktuara në mandatin e investimeve dhe në përputhje me kërkesat rregullatore, drejtuesi i fondit ka të drejta vendimmarrëse që i japin atij aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme të fondit - investitorët nuk zotërojnë të drejta thelbësore që mund të ndikojnë në autoritetin e vendimmarrjes të drejtuesit të fondit. Drejtuesi i fondit merr një tarifë të bazuar në treg për shërbimet e tij, që është në përpjesëtim të drejtë me shërbimet e ofruara, dhe ka bërë edhe një investim proporcional në fond. Shpërblimi dhe investimet e tij e ekspozojnë drejtuesin e fondit ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga veprimtaritë e fondit, pa krijuar ekspozim të një rëndësie të tillë që tregon se drejtuesi i fondit është kryesori.

Në këtë shembull, marrja në konsideratë e ekspozimit të drejtuesit të fondit ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga fondi, së bashku me autoritetin e vendimmarrjes brenda parametrave të kufizuar, tregon se ai është një agjent. Kështu, drejtuesi i fondit arrin në përfundimin se ai nuk e kontrollon fondin.

Shembulli 14

Një vendimmarrës krijon, tregon dhe drejton një fond që u ofron mundësi investimi një numri investitorësh. Vendimmarrësi (drejtuesi i fondit) duhet të marrë vendime në të mirë të interesave të të gjithë investitorëve dhe në përputhje me marrëveshjet e qeverisjes së fondit. Megjithatë, drejtuesi ka shkallë të lartë lirie në vendimmarrje. Drejtuesi i fondit merr një shpërblim sipas tarifës të bazuar në treg për shërbimet e tij, të barabartë me 1 për qind të aktiveve që ka në administrim dhe 20 për qind të të gjitha fitimeve të fondit, në qoftë se është arritur një nivel i caktuar fitimi. Tarifat janë në përpjesëtim me shërbimet e ofruara.

Edhe pse ai duhet të marrë vendime në interes të të gjithë investitorëve, drejtuesi i fondit ka autoritet të plotë të vendimmarrjes për të drejtuar veprimtaritë e rëndësishme të fondit. Drejtuesi i fondit paguhet me një pagë fikse dhe një shpërblim në varësi të performancës, në mënyrë përpjestimore me shërbimet e ofruara. Përveç kësaj, shpërblimi bën që interesat e drejtuesit të fondit të jenë në të njëjtën linjë me ato të investitorëve të tjerë për të rritur vlerën e fondit, pa krijuar ekspozim ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga veprimtaritë e fondi. Kjo është e rëndësishme, sepse shpërblimi, i konsideruar në veçanti, tregon se drejtuesi i fondit është kryesori.

Modeli faktik i paraqitur më lart dhe analiza vlen për shembujt 14A–14C të përshkruara më poshtë. Çdo shembull është konsideruar si shembull i veçantë.

Shembull 14A

Drejtuesi i fondit ka gjithashtu një investim 2 për qind në fond, duke bërë që interesat e veta të jenë në përputhje me ato të investitorëve të tjerë. Drejtuesi i fondit nuk ka ndonjë detyrim për të financuar humbjet përtej 2 për qind të investimit. Investitorët mund ta heqin drejtuesin me një shumicë të thjeshtë votash, por vetëm për shkelje të kontratës.

Investimi 2 për qind i drejtuesit të fondit rrit ekspozimin e tij ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga veprimtaritë e fondit pa krijuar ekspozim, të një rëndësie të tillë, që tregon se drejtuesi i fondit është kryesori. Të drejtat e investitorëve të tjerë për të hequr drejtuesin e fondit konsiderohen të jenë të drejta mbrojtëse meqë ato janë të ushtrueshme vetëm kur ka shkelje të kontratës. Në këtë shembull, edhe pse drejtuesi i fondit ka shkallë të lartë autoriteti të vendimmarrjes dhe është i ekspozuar ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga interesi dhe shpërblimi i tij, ekspozimi i drejtuesit të fondit tregon se ai është një agjent. Kështu, drejtuesi i fondit arrin në përfundimin se ai nuk e kontrollon fondin.

Shembulli 14B

Drejtuesi i fondit ka një investim përpjesëtimisht më thelbësor në fond, por nuk ka ndonjë detyrim për të financuar humbjet përtej këtij investimi. Investitorët mund ta heqin drejtuesin me një shumicë të thjeshtë votash, por vetëm për shkelje të kontratës.

Në këtë shembull, të drejtat e investitorëve të tjerë për të hequr drejtuesin e fondit konsiderohen të jenë të drejta mbrojtëse për shkak se ato janë të ushtrueshme vetëm kur ka shkelje të kontratës. Edhe pse drejtuesi i fondit paguhet me një tarifë fikse dhe në varësi të performancës, që është në përpjesëtim të drejtë me shërbimet e ofruara, kombinimi i investimit të drejtuesit të fondit së bashku me shpërblimin e tij mund të krijojë ekspozim ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga veprimtaritë e fondit, që është e një rëndësie të tillë, që tregon se drejtuesi i fondit është një kryesor. Sa më e madhe të jetë madhësia dhe ndryshueshmëria

Shembuj të zbatimit

e lidhur me interesat ekonomike të drejtuesit të fondit të (duke pasur parasysh shpërblimin e vet dhe interesat e tjera në tërësi), sa më tepër rëndësi t'i kushtojë nga drejtuesi i fondit këtyre interesave ekonomike gjatë analizës, aq më shumë ka të ngjarë që ai të jetë kryesori.

Për shembull, duke marrë parasysh shpërblimin e tij dhe faktorë të tjerë, drejtuesi i fondit mund ta quajë se është i mjaftueshëm një 20 për qind e investimeve për të arritur në përfundimin se ai kontrollon fondin. Megjithatë, në rrethana të ndryshme (p.sh. nëse shpërblimi apo faktorë të tjerë janë të ndryshëm), kontrolli mund të evidentohet kur niveli i investimeve është i ndryshëm.

Shembull 14C

Drejtuesi i fondit ka përpjesëtimisht një 20 për qind investime në fond, por nuk ka ndonjë detyrim për të financuar humbjet përtej këtij 20 për qindëshit. Fondi ka një bord të drejtorëve, të gjithë anëtarët e të cilit janë të pavarur nga drejtuesi i fondit dhe emërohen nga investitorë të tjerë. Bordi emëron drejtuesin e fondit çdo vit. Nëse bordi vendosi të mos rinovojë kontratën e drejtuesit të fondit, shërbimet e kryera nga drejtuesi i fondeve mund të kryhen nga drejtuesit e tjerë të industrisë.

Edhe pse drejtuesi i fondit paguhet me një pagë fikse dhe në varësi të performancës, që janë në përputhje me shërbimet e ofruara, kombinimi i investimit prej 20 për qind i drejtuesit të fondit së bashku me shpërblimin e tij krijon ekspozim ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga veprimtaritë e fondit. Një gjë e tillë ka rëndësi se tregon që drejtuesi i fondit është kryesori. Megjithatë, investitorët kanë të drejta thelbësore për të hequr drejtuesin e fondit- bordi i drejtorëve siguron një mekanizëm për të garantuar se investitorët mund ta heqin drejtuesin e fondit, nëse ata vendosin ta bëjnë një gjë të tillë.

Në këtë shembull, drejtuesi i fondit e vë theksin më tepër në të drejtat thelbësore të heqjes gjatë analizës. Kështu, edhe pse drejtuesi i fondit ka mjaft autoritet në vendimmarrje dhe është i ekspozuar ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve të fondit si rezultat i shpërblimit dhe investimit i i tij, të drejtat thelbësore të zotëruara nga investitorët e tjerë tregojnë se drejtuesi i fondit është një agjent. Kështu, drejtuesi i fondit arrin në përfundimin se ai nuk e kontrollon fondin.

Shembulli 15

Një i investuar është krijuar për të blerë një portofol të letrave me vlerë me normë fikse, të garantuar me aktiv, financiar nga instrumente borxhi me normë fikse dhe instrumente të kapitalit neto. Instrumentet e kapitalit neto janë të përcaktuara për të siguruar mbrojtje për investitorët e borxhit nga humbja e parë dhe për të marrë kthimet e mbetura të të investuarit. Transaksioni u tregtohet investitorëve potencialë të borxhit si një investim në një portofol të letrave me vlerë, të garantuar me aktive, me ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë, lidhur me ndonjë mospagim të mundshëm të emetuesit të këtyre letrave me vlerë, dhe ndaj rrezikut të normës së interesit të lidhur me drejtimin e portofolit. Në momentin e formimit, instrumentet e kapitalit neto përfaqësojnë 10 përqind të vlerës së aktiveve të blera. Një vendimmarrës (shoqëria administruuese) drejton portofolin veprues të aktiveve duke marrë vendime për investime brenda parametrave të përcaktuara në prospektin e të investuarit. Për këto shërbime, shoqëria administruuese paguhet me një tarifë fikse të bazuar në treg (d.m.th. 1 për qind e aktiveve që janë nën drejtim) dhe me një tarifë të lidhur me performancën (d.m.th. 10 për qind e fitimeve), në qoftë se fitimet e investuarit tejkalojnë një nivel të caktuar. Tarifat janë në përpjesëtim me shërbimet e ofruara. Shoqëria administruuese zotëron 35 për qind të kapitalit neto të të investuarit. Pjesa e mbetur prej 65 për qind e kapitalit neto, si dhe të gjitha instrumentet e borxhit, zotërohen nga një numër i madh investitorësh, si palë e tretë e palidhur, me një shpërndarje të gjerë. Shoqëria administruuese mund të hiqet pa shkak, me vendim të shumicës së thjeshtë të investitorëve të tjerë.

Shoqëria administruuese paguhet me tarifë fikse dhe tarifë të lidhur me performancën, që janë proporcionale me shërbimet e ofruara. Shpërblimi bën që interesat e drejtuesit të fondit të jenë në të njëjtën linjë me ato të investitorëve të tjerë për rritjen e vlerës së fondit. Shoqëria administruuese është e ekspozuar ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga veprimtaritë e fondit, sepse zotëron 35 për qind të kapitalit neto dhe si rezultat i shpërblimit që merr.

Edhe pse vepron brenda parametrave të përcaktuar në prospektin e të investuarit, shoqëria administruuese ka aftësinë aktuale të marrë vendime për investime, që ndikojnë dukshëm në kthimet e të investuarit -të drejtat e heqjes, të zotëruara nga investitorë të tjerë, zënë një peshë specifike të vogël gjatë analizës, sepse këto të drejta zotërohen nga një numër i madh investitorësh me shpërndarje të gjerë. Në këtë shembull, shoqëria administruuese i kushton më tepër rëndësi ekspozimit të saj ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve të fondit nga interesat e kapitalit neto, që janë në varësi të instrumenteve të borxhit. Zotërimi 35 për qind i kapitalit neto krijon ekspozim të varur ndaj humbjeve dhe të drejtave në kthimet e të investuarit, të një rëndësie të tillë që tregon se shoqëria administruuese është kryesoria. Kështu, shoqëria administruuese arrin në përfundimin se kontrollon të investuarin.

Shembuj të zbatimit**Shembulli 16**

Një vendimmarrës (sponsor) sponsorizon një kanal me disa shitës, që emeton instrumente borxhi afatshkurtra tek investitorët e palidhur, palë e tretë. Transaksioni u tregtohet investitorëve potencialë, si një investim në një portofol të aktiveve afatmesme me norma të larta, me ekspozim minimal ndaj rrezikut të kredisë, që lidhet me mospagimin e mundshëm nga ana e emetuesve të aktiveve në portofol. Transferues të ndryshëm shesin portofole aktiveve afatmesme të cilësisë të lartë në kanal. Çdo transferues i shërben portofolit të aktiveve që ai shet në kanal dhe administron llogaritë e arkëtueshme, që nuk paguhet në kohë, kundrejt një tarife shërbimi bazuar në treg. Çdo transferues siguron, gjithashtu, mbrojtjen nga humbja e parë në rastin e humbjeve të kredisë nga portofoli i tij i aktiveve nëpërmjet mbi –kolateralizimit të aktiveve të transferuara në kanal. Sponsor përcakton kushtet e kanalit dhe drejton operacionet në të kundrejt një tarife të bazuar në treg. Tarifa është proporcionale me shërbimet e ofruara. Sponsor miraton shitësit e lejuar për të shitur në kanal, miraton aktivet që do të blihen prej kanalit dhe merr vendime në lidhje me financimin e tij. Sponsor duhet të veprojë në të mirë të interesit të të gjithë investitorëve.

Sponsor ka të drejtë mbi çdo kthim të mbetur të kanalit dhe gjithashtu siguron aktiv që mbahet si garanci kredie dhe lehtësira likuiditeti në kanal. Aktiv i dhënë nga sponsor, si garanci kredie, përfshihet humbjet deri në 5 për qind të të gjithë aktiveve të kanalit, pasi humbjet të jenë për thithur nga transferuesi. Lehtësirat e likuiditetit nuk janë shumë të avancuara kundrejt aktiveve të mos paguara. Investitorët nuk zotërojnë të drejta thelbësore që mund të ndikojnë në autoritetin e vendimmarrjes të sponsorit.

Edhe pse sponsor paguhet për shërbimet e tij me një tarifë të bazuar në treg, që është në proporcion me shërbimet e ofruara, ai ekspozohet ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga veprimtaritë e kanalit, për shkak të të drejtave të tij në kthimet e mbetura të kanalit dhe sigurimit të aktivitetit si garanci kredie si dhe të lehtësirave të likuiditetit (d.m.th. kanali është i ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit, nga përdorimi i instrumenteve të borxhit afatshkurtra për të financuar aktivet afatmesme). Edhe pse secili prej transferuesve ka të drejta vendimmarrëse, që ndikojnë në vlerën e aktiveve të kanalit, sponsor ka autoritet të shtrirë vendimmarrjeje që i jep aftësinë aktuale për të drejtuar veprimtaritë, që ndikojnë më ndjeshëm në kthimet e kanalit (d.m.th. sponsor vendos kushtet e kanalit, ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me aktivet (duke miratuar aktivet e blera dhe transferuesit e këtyre aktiveve) dhe financimin e kanalit (për të cilin investimi i ri duhet të financohet mbi një bazë të rregullt)). E drejta për kthimet e mbetura të kanalit dhe sigurimi i aktivitetit si garanci kredie dhe i lehtësirave të likuiditetit ekspozojnë sponsorin ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga veprimtaritë e kanalit, që është i ndryshëm nga ai i investitorëve të tjerë. Prandaj, ky ekspozim tregon se sponsor është kryesori dhe për këtë arsye sponsor arrin përfundimin se kontrollon kanalin. Detyrimi i sponsorit për të vepruar në të mirë të interesit të të gjithë investitorëve nuk e pengon sponsorin të jetë një kryesor.

Marrëdhëniet me palët e tjera

- B73 Gjatë vlerësimit të kontrollit, investitori do të marrë parasysh natyrën e marrëdhënieve të tij me palët e tjera dhe nëse këto palë të tjera janë duke vepruar në emër të investitorit (d.m.th. janë 'agjentë de facto'). Përcaktimi nëse palët e tjera janë duke vepruar si agentë de facto kërkon gjykim, duke marrë parasysh jo vetëm natyrën e marrëdhënieve, por edhe mënyrën sesi këto palë ndërveprojnë me njëra-tjetrën dhe investitorin.
- B74 Një marrëdhënie e tillë nuk ka nevojë të përfshijë një marrëveshje kontraktuale. Një palë është një agjent de facto kur investitori ka aftësinë për të drejtuar këtë palë që të veprojë në emër të investitorit. Një palë mund të jetë një agjent de facto edhe kur ata që drejtojnë veprimtaritë e investitorit kanë aftësinë për të drejtuar këtë palë që të veprojë në emër të investitorit. Investitori duhet të marrë parasysh të drejtat e vendimmarrjes të agjentit de facto dhe ekspozimin e tij të tërthortë, ose të drejtat ndaj kthimeve të ndryshueshme përmes agjentit de facto së bashku me atë vetë, kur vlerëson kontrollin mbi një të investuar.
- B75 Më poshtë jepen shembuj të këtyre palëve të tjera, që nga natyra e marrëdhënies së tyre, mund të veprojë si agjentë de facto për investitorin:
- (a) palët e lidhura të investitorit.
 - (b) një palë që ka interesin e saj tek i investuari si një kontribut ose hua nga investitori.
 - (c) një palë që ka rënë dakord të mos shesë, transferojë ose pengojë interesat e saj tek i investuari, pa miratimin paraprak të investitorit (me përjashtim të situatave në të cilat investitori dhe pala tjetër kanë të drejtën e miratimit paraprak dhe të drejtat janë të bazuara në kushtet e pranuar reciprokisht në mënyrë të vullnetshme nga palët e pavarura).

- (d) një palë që nuk mund të financojë operacionet e saj pa mbështetjen financiare të varur nga investitori.
- (e) një i investuar, ku shumica e anëtarëve të bordit të tij qeverisës, ose personeli drejtues kryesor i tij janë të njëjtë me ata të investitorit.
- (f) një palë që ka një marrëdhënie të ngushtë biznesi me investitorin, e tillë si marrëdhënia midis një ofruesi shërbimi profesional dhe njërit prej klientëve të tij të rëndësishëm.

Kontrolli i aktiveve të specifikuara

- B76 Një investitor do të shqyrtojë nëse ai e trajton një pjesë të një të investuari si një njësi ekonomike të supozuar të veçantë dhe, nëse është kështu, a ka kontroll mbi të.
- B77 Një investitor do ta trajtojë një pjesë të një të investuari si një njësi ekonomike të supozuar të veçantë, atëherë dhe vetë atëherë kur, plotësohet kushti i mëposhtëm:
- Aktivet e specifikuara të të investuarit (dhe aktive të mbajtura si garanci kredie, nëse ka ndonjë) janë burim i vetëm i pagesës për detyrimet e specifikuara apo interesa të tjera të specifikuara të të investuarit. Palët e tjera, përveç atyre me detyrim të specifikuar, nuk kanë të drejta ose detyrime që lidhen me aktivet e specifikuara apo flukset monetare të mbetura nga këto aktive. Në thelb, pjesa e mbetur e të investuarit nuk mund të përdorë asnjë prej kthimeve nga aktivet e specifikuara dhe asnjë prej detyrimeve të njësisë ekonomike, e supozuar e veçantë, nuk paguhet nga aktivet e pjesës së mbetur të të investuarit. Kështu, në thelb, të gjitha aktivet, detyrimet dhe kapitali neto i njësisë ekonomike, e supozuar e veçantë, mbahen për një qëllim nga i investuari i përgjithshëm. Një njësi ekonomike e tillë e supozuar e veçantë quhet shpesh një 'silos'.
- B78 Kur plotësohet kushti në paragrafin B77, një investitor do të identifikojë veprimtaritë që ndikojnë ndjeshëm në kthimet e njësisë ekonomike, e supozuar e veçantë, dhe mënyrën se si janë drejtuar këto veprimtari që të vlerësojë nëse ai ka fuqi mbi këtë pjesë të të investuarit. Gjatë vlerësimit të kontrollit të kësaj njësie, investitori do të marrë, gjithashtu, në konsideratë nëse ka ekspozim ose të drejta ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e tij në këtë njësi ekonomike, e supozuar e veçantë, dhe aftësinë për të përdorur fuqinë e tij mbi këtë pjesë të të investuarit për të ndikuar në shumën e kthimeve të tij.
- B79 Nëse investitori kontrollon njësinë ekonomike, e supozuar e veçantë, ai do të konsolidojë këtë pjesë të investuarit. Në këtë rast, palët e tjera e përjashtojnë këtë pjesë të të investuarit gjatë vlerësimit të kontrollit dhe në konsolidimin e të investuarit.

Vlerësimi i vazhdueshëm

- B80 Një investitor do të rivlerësojë nëse ai kontrollon një të investuar, në qoftë se faktet dhe rrethanat tregojnë se ka ndryshime në një ose më shumë prej tri elementeve të kontrollit, të renditura në paragrafin 7.
- B81 Nëse ka një ndryshim në mënyrën e ushtrimit të fuqisë mbi një të investuar, ky ndryshim duhet të reflektohet në atë se si një investitor vlerëson fuqinë e tij mbi një të investuar. Për shembull, ndryshimet në të drejtat e vendimmarrjes mund të tregojnë se veprimtaritë e rëndësishme nuk drejtohen më përmes të drejtave të votës, por, në vend të kësaj, marrëveshje të tjera, të tilla si kontratat, i japin një palë tjetër apo palëve të tjera aftësinë aktuale për t'i drejtuar ato.
- B82 Një ngjarje mund të bëjë që një investitor të fitojë apo të humbasë fuqi mbi një të investuar, pa qenë i përfshirë në këtë ngjarje. Për shembull, një investitor mund të ketë fuqinë mbi një të investuar ngaqë nuk ekzistojnë më të drejtat e vendimmarrjes, të zotëruara nga një palë tjetër apo palë të tjera, që paraprakisht e ndalonin investitorin nga kontrolli mbi një të investuar.
- B83 Një investitor merr parasysh gjithashtu ndryshimet që ndikojnë në ekspozimin e tij, ose të drejtat e tij ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e tij me një të investuar. Për shembull, një investitor që ka fuqi mbi një të investuar mund të humbasë kontrollin mbi të, nëse investitori pushon të ketë të drejtën të marrë kthimet ose të jetë i ekspozuar ndaj detyrimeve, sepse investitori nuk do të arrijë të plotësonte paragrafin 7(b) (p.sh. nëse ndërpritet një kontratë për t'u shpërblyer sipas tarifave të lidhura me performancën).
- B84 Një investitor do të shqyrtojë nëse ka ndryshim në vlerësimin e tij se ai vepron si një agjent apo një kryesor. Ndryshimet në marrëdhëniet e përgjithshme midis investitorit dhe palëve të tjera mund të tregojnë se një investitor nuk vepron më si një agjent, edhe pse ka vepruar më parë si një i tillë, dhe anasjelltas. Për shembull, në qoftë se ndodhin ndryshime në të drejtat e investitorit ose të palëve të tjera, investitori do të rishqyrtojë statusin e tij si një kryesor ose një agjent.
- B85 Vlerësimi fillestar i një investitori, në lidhje me kontrollin apo statusin e tij si një kryesor ose një agjent, nuk do të ndryshojë, thjesht, për shkak të një ndryshimi në kushtet e tregut (p.sh. një ndryshim në kthimet e të investuarit për shkak të kushteve të tregut), përveç rastit kur ndryshimet në kushtet e tregut bëjnë që të

ndryshojnë një ose më shumë prej tre elementeve të kontrollit, të renditura në paragrafin 7, ose të ndryshojnë marrëdhëniet e përgjithshme në mes të një kryesori dhe një agjenti.

Përcaktimi nëse një njësi ekonomike është njësi ekonomike investuese

- B85A** Një njësi ekonomike do të konsiderojë të gjithë faktet dhe rrethanat nëse është një njësi ekonomike investuese, përfshi dhe qëllimin dhe dizajnin e saj. Një njësi ekonomike që përmbush të tre elementët e përkufizimit të një njësie ekonomike investuese të përcaktuara në paragrafin 27, është një njësi ekonomike investuese. Paragrafët B85B–B85M përshkruajnë elementët e përkufizimit në detaje të hollësishme.

Biznesi si qëllim

- B85B** Përkufizimi i një njësie ekonomike investuese kërkon që qëllimi i njësisë ekonomike të jetë investimi për qëllimin e vetëm të rritjes së vlerës së kapitalit, të marrë të ardhura nga investimi (siç janë dividendët, interesi ose e ardhura nga qiraja) ose të dyja. Dokumente që japin indikatorë se cili është objektivi i njësisë ekonomike investuese janë të tillë si dokumenti ku përshkruhen llojet e instrumenteve që ofron shoqëria (memorandumi i ofertave), publikimet e shpërndara nga vetë njësia ekonomike ose nga njësi të tjera në partneritet me të, do të japin pikërisht evidencë për qëllimin e biznesit të njësisë ekonomike investuese. Evidencë tjetër mund të jetë mënyra se si njësia ekonomike prezanton veten e saj tek palët e tjera (të tilla si investitorë potencialë apo investime potencialë); për shembull, një njësi ekonomike mund të prezantojë biznesin e saj si ofruese e investimeve afat mesme për rritje të vlerës së kapitalit. Në të kundërt një njësi ekonomike, e cila prezantohet si një investitor, objektivi i të cilit është që bashkë me investuesit e tjerë të zhvillojë, prodhojë ose tregtojë produkte, ka një qëllim biznesi të papajtueshëm me qëllimin e biznesit të një njësie ekonomike investuese, sepse njësia ekonomike do të përfitojë të ardhura nga aktiviteti i zhvillimit, prodhimit apo tregtimit ashtu si dhe nga investimet e saj (shih paragrafin B85I).
- B85C** Një njësi ekonomike investuese mund të ofrojë shërbime të lidhura me investimet (si psh. shërbime të këshillimit për investime, menaxhim investimesh, mbështetje investimesh dhe shërbime administrative), ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet një filiali, për palët e treta apo edhe për investitorët e vet, edhe sikur këto aktivitete të jenë thelbësore për njësinë ekonomike, e cila duhet të vijoje plotësimin e përkufizimit të njësisë ekonomike investuese.
- B85D** Një njësi ekonomike investuese mund të jetë pjesëmarrëse edhe në aktivitetet e mëposhtme të lidhura me investimin, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një filiali, nëse këto aktivitete janë ndërmarrë për të maksimizuar kthimin e investimit (rritje e vlerës së kapitalit ose të ardhura nga investimi) nga të investuarit e saj dhe nuk përfaqësojnë në thelb një aktivitet biznesi të veçantë apo një burim të veçantë të ardhurash për njësinë ekonomike investuese:
- (a) dhënia e shërbimit të drejtimit dhe këshillave strategjike për një të investuar; dhe
 - (b) dhënia e mbështetjes financiare për një të investuar, siç janë huaja, angazhimi ose garantimi i kapitalit.
- B85E** Nëse një njësi ekonomike investuese ka një filial, i cili ofron në vetvete nuk është njësi ekonomike investuese dhe qëllimi dhe aktivitetet kryesore të tij janë ofrimi tek njësia ekonomike ose palë të tjera i shërbimeve ose aktiviteteve të lidhura me investimin, të cilat lidhen me aktivitetet investuese të njësisë ekonomike investuese, të tilla si ato të përshkruara në paragrafët B85C–B85D, ajo do ta konsolidojë këtë filial në përputhje me paragrafin 32. Nëse filiali që ofron shërbime ose aktivitete të lidhura me investimin është në vetvete një njësi ekonomike investuese, shoqëria mëmë investuese do ta masë këtë filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 31.

Strategjia e daljes

- B85F** Planet e investimit të një njësie ekonomike japin evidencë për qëllimin e biznesit gjithashtu. Një tipar që diferencon një njësi ekonomike investuese nga njësitë e tjera ekonomike, është që një njësi ekonomike investuese nuk planifikon të mbajë investimet e saj në një kohë të pacaktuar; ajo i mban ato për një periudhë kohore të kufizuar. Për shkak se investimet kapitale dhe investimet me karakter jo financiar kanë potencialin për t'u mbajtur për një kohë të pacaktuar, një njësi ekonomike investuese duhet të ketë një strategji dalje e cila dokumenton se si njësia ekonomike planifikon të realizojë rritjen e vlerës së kapitalit në dallim nga investimet e tij kapitale dhe investimet jo financiare. Një njësi ekonomike investuese gjithashtu do të ketë një strategji dalje për çdo instrument borxhi që ka potencial për t'u mbajtur për një kohë të pacaktuar, për shembull një investim i përjetshëm borxhi. Njësia ekonomike nuk është nevoja të dokumentojë strategji dalje specifike për çdo investim individualisht por do të identifikojë strategji potenciale të veçanta për lloje apo portofole të ndryshme investimesh, duke përfshirë një afat kohor

thelbësor për daljen nga investimi. Mekanizmat e daljes që janë vendosur për ngjarje të parazgjedhura si prishja e kontratës, mos performanca, nuk konsiderohen si strategji dalje, për qëllim të këtij vlerësimi.

- B85G** Strategjitë e daljes mund të variojnë nga lloji i investimit. Për investime në letra me vlerë të kapitalit neto, shembuj të strategjisë së daljes përfshijnë një ofertë publike fillestare, një vendosje private, një shitje tregtare të biznesit, shpërndarje (tek investitorët) e interesave të pronësisë të të investuarëve dhe shitjen e aktiveve (përfshi shitjen e aktiveve të një të investuari që pasohet nga likuidimi i të investuarit). Për investimet në kapitale neto që janë të tregtueshme në tregun publik, shembuj të strategjisë së daljes përfshijnë shitjen e investimit në një vendosje private ose në një treg publik. Për investimet në pasuri të paluajtshme, një shembull i një strategjie dalje është shitja e pasurisë së paluajtshme nëpërmjet agjentëve të specializuar të pronave ose në treg të hapur.
- B85H** Një njësi ekonomike investuese mund të ketë një investim në një njësi tjetër investuese që është formuar në lidhje me njësinë ekonomike për arsye ligjore, rregullatore, fiskale, ose të tjera arsye të ngjashme biznesi. Në këtë rast, investitori në njësinë ekonomike investuese nuk ka nevojë për një strategji dalje për këtë investim, me kusht që i investuari njësi ekonomike investuese ka një strategji dalje të përshtatshme për investimet e saj.

Fitimet nga investimet

- B85I** Një njësi ekonomike nuk mund të quhet se ka investuar vetëm për rritje të vlerës së kapitalit, të ardhura nga investimi ose për të dyja, në qoftë se njësia ekonomike ose një anëtar i grupit që zotëron njësinë ekonomike (që do të thotë grupi është i kontrolluar nga një njësi ekonomike investuese shoqëri mëmë përfundimtare) merr ose ka si objektiv të marrë përfitime të tjera nga investimet e njësisë ekonomike që nuk janë të përfitueshme për palët e tjera që nuk janë të lidhura me të investuarin. Përfitime të tilla janë:
- (a) blerja, përdorimi, shkëmbimi ose shfrytëzimi i procesit, aktivitetit ose i teknologjisë së një të investuari. Kjo mund të përfshijë një njësi ekonomike ose një anëtar tjetër të grupit që ka të drejta ekskluzive ose të drejta prioritare për të blerë aktive, teknologji, produkte ose shërbime të një të investuari; për shembull, të kesh një opsion për të blerë një aktiv nga një i investuar në qoftë se zhvillimi i atij aktivi del me sukses;
 - (b) marrëveshjet e përbashkëta (siç përcaktohen në SNRF 11) ose marrëveshje të tjera midis njësisë ekonomike ose një anëtar të grupit dhe një të investuari për të zhvilluar, tregtuar ose lëvrimi i produkteve dhe shërbimeve;
 - (c) garancitë financiare ose aktivet e ofruara nga një i investuar për t'i shërbyer si kolateral për transaksione huamarrje të njësisë ekonomike ose një anëtari tjetër të grupit (sidu qoftë një njësi ekonomike investuese do ishte sërish në gjendje të përdorte një investim në një të investuar si kolateral për çdo huamarrje);
 - (d) një opsion i mbajtur nga një palë e lidhur me njësinë ekonomike për të blerë, nga ajo njësi ekonomike ose nga një tjetër anëtar i grupit, një interes pronësie në një të investuar të njësisë ekonomike;
 - (e) me përjashtim të asaj që është shpjeguar në paragrafin B85J, transaksionet midis një njësie ekonomike ose një anëtari tjetër të grupit dhe një i investuar të cilat:
 - (i) janë në terma të tilla që nuk u ofrohen njësive ekonomike që nuk janë palë të lidhura me njësinë ekonomike, me një anëtar tjetër të grupit, apo me të investuarin;
 - (ii) nuk janë me vlerën e drejtë; ose
 - (iii) përfaqëson një pjesë thelbësore të aktivitetit të biznesit të të investuarit ose të njësisë ekonomike, duke përfshirë dhe aktivitetin e biznesit të njësive të tjera ekonomike të grupit.
- B85J** Një njësi ekonomike investuese mund të ketë një strategji për të investuar në më shumë se një të investuar në të njëjtën industri, treg ose zone gjeografike në mënyrë që të përfitojë nga sinergjitë që sjellin rritje të vlerës së kapitalit dhe të të ardhurave nga investimi nga këto të investuar. Pavarësisht nga paragrafi B85I(e), një njësi ekonomike nuk do të skualifikohet nga të qenët si njësi ekonomike investuese thjesht sepse këta të investuar tregtojnë me njëri tjetrin.

Matja me vlerën e drejtë

- B85K** Një element esencial i përkufizimit të një njësie ekonomike investuese është që ajo i mat dhe vlerëson performancën e pothuaj të gjithë investimeve të saj me vlerën e drejtë, sepse përdorimi i rezultateve të vlerës së drejtë është informacion më i përshtatshëm sesa psh., konsolidimi i filialeve të saj ose përdorimi i

metodës së kapitalit neto për pjesëmarrjet në sipërmarrje të asocjuara apo të përbashkëta. Në mënyrë që të demonstrojë që ajo e përbush këtë element të përkufizimit, një njësi ekonomike investuese:

- (a) paraqet tek investitorët informacion me vlerën e drejtë dhe mat pothuaj të gjitha investimet e saj me vlerë të drejtë në pasqyrat financiare të saj atje ku kriteri i vlerës së drejtë kërkohet apo lejohet në përputhje me SNRF-të. dhe
- (b) raporton me vlerë të drejtë në mënyrë të brendshme tek personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike (siç përcaktohet në SNK 24), i cili përdor vlerën e drejtë si një atribut primar për të vlerësuar performancën e pothuaj të gjithë investimeve të saj dhe për të marrë vendime për investime.

B85L Në mënyrë që të plotësohen kërkesat sipas B85K(a), një njësi ekonomike investuese duhet:

- (a) të zgjedhë kontabilitetin e modelit të vlerës së drejtë për çdo aktiv afatgjatë material të investuar sipas SNK 40 *Aktiv afatgjatë material i investuar*;
- (b) të zgjedhë përjashtimin e aplikimit të metodës së kapitalit neto sipas SNK 28 për investimet e saj në sipërmarrje të asocjuara apo të përbashkëta; dhe
- (c) të masë aktivet e veta financiare me vlerën e drejtë duke përdorur kërkesat e SNRF 9.

B85M Një njësi ekonomike investuese mund të ketë disa aktive afatgjate jo-të investuara siç mund të jenë ndërtesa e zyrave qendrore dhe pajisjeve përkatëse, dhe mundet gjithashtu të ketë detyrime financiare. Elementi i matjes me vlerën e drejtë të përkufizimit të një njësie ekonomike investuese në paragrafin 27(c) aplikohet për një investim të kryer nga njësia ekonomike investuese. Në këto rrethana, një njësi ekonomike investuese nuk ka nevojë që aktivet e saj jo-të investuara dhe detyrimet t'i masë me vlerën e drejtë.

Karakteristikat tipike të një njësie ekonomike investuese

B85N Në përcaktimin nëse plotësohet përkufizimi i një njësie ekonomike investuese, njësia ekonomike do të konsiderojë nëse ajo shfaq karakteristikat tipike të një të tilla (shiko paragrafin 28). Mungesa e një apo më shumë prej këtyre karakteristikave tipike, jo domosdoshmërisht bën që njësia ekonomike të skualifikohet si njësi ekonomike investuese, por jep indikatorë që nevojitet një gjykim shtesë për të përcaktuar nëse një njësi ekonomike është njësi ekonomike investuese apo jo.

Më shumë sesa një investim

B85O Një njësi ekonomike investuese tipike ka shumë lloj investimesh në mënyrë që të diversifikojë rrezikun dhe të maksimizojë të ardhurat. Një njësi ekonomike mund të ketë një portofol investimesh direkte ose indirekte, për shembull duke zotëruar një investim në një tjetër njësi ekonomike investuese e cila në vetvete ka shumë investime.

B85P Mund të ketë edhe kohëra të tilla, kur njësia ekonomike zotëron vetëm një investim. Sido qoftë, zotërimi i një investimi të vetëm nuk e ndalon domosdoshmërisht një njësi ekonomike të plotësojë kushtet e përkufizimit të një njësie ekonomike investuese. Për shembull, një njësi ekonomike investuese mund të zotërojë vetëm një investim të vetëm atëherë kur njësia ekonomike:

- (a) ndodhet në periudhë fillestare dhe ende nuk ka arritur të identifikojë investime të përshtatshme, dhe si pasojë, nuk ka zbatuar ende planin e saj të investimeve për të blerë shumë investime;
- (b) nuk ka bërë ende investime të tjera për të zëvendësuar investimet që ka shitur.
- (c) është krijuar si pjesë e një grupi investitorësh për të investuar në një investim të caktuar kur një investitor individual nuk mund ta realizojë (psh. kur kërkesa për investimin minimal është shumë e madhe për një investitor individual); ose
- (d) është në proces likuidimi.

Më shumë sesa një investitor

B85Q Në mënyrë të veçantë, një njësi ekonomike investuese do të kishte shumë investitorë të cilët grumbullojnë fondet e tyre për të patur akses tek shërbimet e drejtimit të investimeve dhe mundësi të investimit që ata mund të mos kenë patur akses në mënyrë individuale. Të paturit e shumë investitorëve e bën më pak të mundur që njësia ekonomike ose anëtarët e tjerë të grupit që zotërojnë njësinë, do të siguronin përfitime të tjera, përveç se rritja e vlerës së kapitalit dhe të ardhurat nga investimi (shiko paragrafin B85I).

B85R Në mënyrë alternative, një njësi ekonomike investuese mund të formohet nga ose prej një investitori që përfaqëson ose mbështet interesin e një grupi më të gjerë investitorësh (si psh. fondet e pensionit, fondet qeveritare të investimit ose fondet e besuara familjare).

- B85S Mund të ketë edhe kohëra të tilla, kur njësia ekonomike përkohësisht ka një investitor të vetëm. Për shembull, një njësi ekonomike investuese mund të ketë vetëm një investitor atëherë kur njësia ekonomike:
- (a) është në periudhën fillestare të ofertave, e cila nuk ka mbaruar ende dhe njësia ekonomike intensivisht është duke identifikuar investitorë të përshtatshëm;
 - (b) nuk ka identifikuar ende investitorë të përshtatshëm për të zëvendësuar interesat pronësore që janë paguar; ose
 - (c) është në proces likuidimi.

Investitorët e pa lidhur

- B85T Në mënyrë të veçantë, një njësi ekonomike investuese ka disa investitorë që nuk janë palë të lidhura (siç përcaktohet në SNK 24) me njësinë ekonomike ose me ndonjë nga anëtarët e grupit që zotëron njësinë ekonomike. Të paturit e investitorëve të palidhur e bën më pak të mundur që njësia ekonomike ose anëtarët e tjerë të grupit që zotërojnë njësinë, do të siguronin përfitime të tjera, përveç se rritja e vlerës së kapitalit dhe të ardhurat nga investimi (shiko paragrafin B85I).
- B85U Gjithsesi, një njësi ekonomike mund të kualifikohet si njësi ekonomike investuese edhe pse investitorët janë palë të lidhura me njësinë ekonomike. Për shembull, një njësi ekonomike investuese mund të krijojë veçmas një fond "paralel" për një grup të punonjësve të saj (si psh. për personelin drejtues kryesor) ose për një pjesë të investitorëve të lidhur, e cila ndjek në mënyrë identike (si pasqyrë) investimin kryesor të njësive ekonomike investuese. Ky fond "paralel" mund të kualifikohet si një njësi ekonomike investuese edhe pse të gjithë investitorët e tij janë palë të lidhura.

Interesi i pronësisë

- B85V Një njësi ekonomike investuese në mënyrë tipike është një njësi ligjore e veçantë, por që nuk është e kërkuar të jetë. Interesat e pronësisë në një njësi ekonomike investuese janë tipike në formën e interesave të kapitalit neto ose të ngjashme (si psh. interesa të partneritetit), për të cilat atribuohen proporcionalisht pjesë të aktiveve neto të njësive ekonomike investuese. Megjithatë, të paturit e klasave të diferencuara të investitorëve, disa prej të cilëve kanë të drejta vetëm për një investim specifik apo grup investimesh, ose të cilët kanë proporcione të ndryshme të aksioneve në aktivet neto, nuk e parandalojnë një njësi ekonomike për të qenë njësi ekonomike investuese.
- B85W Në vazhdim, një njësi ekonomike që ka interesa pronësie të konsiderueshme në formën e borxhit që, në përputhje me SNRF-të e tjera të aplikueshme, nuk e plotësojnë përkufizimin e kapitalit neto, mundet që të kualifikohen si një njësi ekonomike investuese, me kusht që mbajtësit e borxhit të jenë të ekspozuar në forma të varjueshme të kthimit nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njësive ekonomike.

Kërkesat e kontabilitetit

Procedurat e konsolidimit

- B86 Pasqyrat financiare të konsoliduara:
- (a) kombinojnë zëra si të aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe flukseve të mjeteve monetare të shoqërisë mëmë me ato të filialeve të saj.
 - (b) kompensojnë (eliminohen) vlerën kontabël të investimit të shoqërisë mëmë në çdo filial me pjesën e kapitalit neto të shoqërisë mëmë të çdo filiali (SNRF 3 shpjegon se si të bëhet kontabilizimi i emrit të mirë përkatës).
 - (c) eliminojnë plotësisht aktivet dhe detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare brenda grupit, që lidhen me transaksionet mes njësive ekonomike të grupit (fitimet ose humbjet, që rezultojnë nga transaksionet brenda grupit me aktive të tilla si inventari dhe aktivet afatgjata materiale, eliminohen plotësisht). Humbjet brenda grupit mund të tregojnë për një zhvlerësim që kërkon të njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara. SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat* zbatohet për diferencat e përkohshme që dalin nga eliminimi i fitimeve dhe humbjeve që rezultojnë nga transaksionet brenda grupit.

Politikat kontabël uniforme

- B87 Nëse një anëtar i grupit përdor politika kontabël të ndryshme nga ato të miratuara në pasqyrat financiare të konsoliduara, për transaksione si dhe ngjarje në rrethana të ngjashme, atëherë bëhen rregullimet e duhura në pasqyrat financiare të këtij anëtar i grupit për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, që të sigurohet pajtueshmëria me politikat kontabël të grupit.

Matja

- B88 Një njësi ekonomike përfshin të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali në pasqyrat financiare të konsoliduara, nga data që siguron kontrollin deri në datën kur njësi ekonomike pushon së kontrolluari filialin. Të ardhurat dhe shpenzimet e filialit bazohen në shumën e aktiveve dhe detyrimeve të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara në datën e blerjes. Për shembull, shpenzimet e amortizimit, të njohura në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pas datës së blerjes, bazohen në vlerat e drejta të aktiveve përkatëse të amortizueshme, të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara në datën e blerjes.

Të drejtat potenciale të votës

- B89 Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, kur ekzistojnë të drejta potenciale të votës, ose derivativët e tjerë që përmbajnë të drejta potenciale të votës, përqindja e fitimit ose e humbjes dhe ndryshimet në kapitalin neto, të ndarë midis shoqërisë mëmë dhe interesave jo kontrolluese, përcaktohet vetëm në bazë të interesave të pronësisë ekzistuese dhe nuk pasqyrojnë ushtrimin e mundshëm apo konvertimin e të drejtave potenciale të votës dhe derivativëve të tjerë, nëse nuk zbatohet paragrafi B90.
- B90 Në disa raste, një njësi ekonomike ka, në thelb, një interes të pronësisë ekzistuese si rezultat i një transaksioni që aktualisht i jep qasje njësisë ekonomike ndaj kthimeve të shoqëruara me një interes të pronësisë. Në rrethana të tilla, në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, pjesa që i takon shoqërisë mëmë dhe interesave jo kontrolluese përcaktohet duke marrë parasysh ushtrimin eventual të këtyre të drejtave potenciale të votës dhe derivativëve të tjerë, që aktualisht i japin qasje njësisë në kthime.
- B91 SNRF 9 nuk zbatohet për interesat në filiale që janë të konsoliduara. Kur instrumentet që përmbajnë të drejtat potenciale të votës, në thelb, aktualisht japin qasje në kthime, që lidhen me një interes të pronësisë në një filial, këto instrumente nuk janë subjekt i kërkesave të SNRF 9. Në të gjitha rastet e tjera, instrumentet që përmbajnë të drejta potenciale të votës në një filial kontabilizohen në përputhje me SNRF 9.

Data e raportimit

- B92 Pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë dhe filialeve të saj të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, do të kenë të njëjtën datë të raportimit. Kur fundi i periudhës raportuese e shoqërisë mëmë është e ndryshme nga ajo e një filiali, atëherë për qëllime konsolidimi, filiali përgatit informacion shtesë financiar për të njëjtën datë si ajo e pasqyrave financiare të shoqërisë mëmë, që shoqëria mëmë të ketë mundësi të konsolidojë informacionin financiar të filialit, përveç kur një gjë e tillë është e pazbatueshme.
- B93 Nëse është e pazbatueshme të bëhet një gjë e tillë, shoqëria mëmë do të konsolidojë informacionin financiar të filialit duke përdorur pasqyrat financiare më të fundit të filialit, të përshtatura për efektet e transaksioneve ose ngjarjeve të rëndësishme, që ndodhin midis datës së këtyre pasqyrave financiare dhe datës së pasqyrave financiare të konsoliduara. Në çdo rast, ndryshimi midis datës së pasqyrave financiare të filialit dhe asaj të pasqyrave financiare të konsoliduara nuk do të jetë më shumë se tre muaj, dhe kohëzgjatja e periudhave të raportimit si dhe çdo diferencë ndërmjet datave të pasqyrave financiare do të jetë e njëjtë nga periudha në periudhë.

Interesat jo kontrolluese

- B94 Një njësi ekonomike do të shpërndajë fitimin ose humbjen dhe çdo element të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse tek pronarët e shoqërisë mëmë dhe interesat jo kontrolluese. Njësia ekonomike, gjithashtu, do t'ua shpërndajë të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në total pronarëve të shoqërisë mëmë dhe interesave jo kontrolluese, edhe në qoftë se kjo nënkupton që interesat jo kontrolluese kanë një tepriçë negative.
- B95 Nëse një filial ka emetuar aksione preferenciale kumulativë, që janë klasifikuar si kapital i vet dhe mbahen nga interesat jo kontrolluese, njësia ekonomike do të llogarisë pjesën e saj të fitimit ose të humbjes pas rregullimit që bëhet për dividendët e këtyre aksioneve, qofshin të deklaruar ose jo këta dividendë.

Ndryshimet në pjesën që zotërohet nga interesat jo kontrolluese

- B96 Kur pjesa e kapitalit neto, që mbahet nga interesat jo kontrolluese, ndryshon, një njësi ekonomike do të rregullojë vlerën kontabël neto të interesave kontrolluese dhe jo-kontrolluese për të pasqyruar ndryshimet në interesat e tyre përkatëse në filial. Njësia ekonomike do të njohë drejtpërdrejt në kapitalin neto çdo diferencë ndërmjet shumës me të cilën interesat jo kontrolluese janë rregulluar dhe vlerës së drejtë të shumës së paguar ose arkëtuar, dhe ua ngarkon atë pronarëve të shoqërisë mëmë.

Humbja e kontrollit

- B97 Një shoqëri mëmë mund të humbasë kontrollin mbi një filial në dy ose më shumë marrëveshje (transaksione). Megjithatë, ndonjëherë rrethanat tregojnë që marrëveshjet e shumëfishta duhet të kontabilizohen si një transaksion i vetëm. Në përcaktimin nëse marrëveshjet do të kontabilizoheshin si një transaksion i vetëm, një shoqëri mëmë do të marrë parasysh të gjitha afatet dhe kushtet e marrëveshjeve dhe efektet e tyre ekonomike. Shoqëria mëmë do të kontabilizonte marrëveshjet e shumëfishta si një transaksion i vetëm, në rastin kur ekzistojnë një ose më shumë nga karakteristikat në vijim:
- (a) Ato janë lidhur në të njëjtën kohë ose në përsiatje të njëra-tjetrës.
 - (b) Ato formojnë një transaksion të vetëm të përcaktuar për të arritur një efekt të përgjithshëm tregtar.
 - (c) Kryerja e një marrëveshjeje varet nga kryerja e të paktën një marrëveshjeje tjetër.
 - (d) Një marrëveshje që më vete konsiderohet si ekonomikisht e pajustificuar, por është ekonomikisht e justifikuar kur konsiderohet së bashku me marrëveshjet e tjera. Një shembull është kur një shitje e aksioneve bëhet me çmim më të ulët se tregu dhe kompensohet nga një shitje e mëvonshme me çmim më të lartë se tregu.
- B98 Nëse një shoqëri mëmë humb kontrollin e një filiali, ajo:
- (a) do të çregjistrojë:
 - (i) aktivet (duke përfshirë çdo emër të mirë) dhe detyrimet e filialit me vlerën e mbetur të tyre kontabël në datën kur kontrolli është humbur; dhe
 - (ii) vlerat e mbetur kontabël të interesave jo-kontrollues në ish-filialin, në datën kur kontrolli është humbur (duke përfshirë çdo komponent të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që u takon atyre).
 - (b) do të njohë:
 - (i) vlerën e drejtë të shumës të marrë, nëse ka, nga transaksioni, ngjarje ose rrethana që çojnë në humbjen e kontrollit;
 - (ii) shpërndarjen e aksioneve, nëse transaksioni, ngjarja apo rrethana, që çoi në humbjen e kontrollit, përfshin një shpërndarje të aksioneve të filialit tek pronarët në cilësinë e tyre si pronarë; dhe
 - (iii) çdo investim të mbetur në ish-filialin me vlerën e drejtë në datën kur kontrolli është humbur.
 - (c) do të ri klasifikojë në fitim ose humbje, ose do të transferojë drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara, në qoftë se kërkohet nga SNRF-të e tjera, shumat e njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në lidhje me filialin, siç është përshkruar në paragrafin B99.
 - (d) do të njohë çdo diferencë që lind si një fitim ose humbje neto në fitimin ose humbjen, që i takon shoqërisë mëmë.
- B99 Nëse një shoqëri mëmë humb kontrollin mbi një filial, ajo do t'i kontabilizojë të gjitha shumat e njohura më parë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në lidhje me këtë filial, mbi të njëjtën bazë si do të kërkohet nëse shoqëria mëmë do të nxirrte drejtpërdrejt jashtë përdorimit aktivitetet dhe detyrimet përkatëse. Prandaj, në qoftë se një fitim ose humbje neto, e njohur më parë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, ri klasifikohet në fitim ose humbje neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve dhe detyrimeve përkatëse, shoqëria mëmë do ta ri klasifikojë fitimin ose humbjen neto nga kapitali neto në fitimin ose humbjen neto (si një rregullim riklasifikimi), kur ajo humb kontrollin mbi filialin. Nëse një tepricë nga rivlerësimi, e njohur më parë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse transferohet drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara me nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivitetit, shoqëria mëmë do të transferojë tepricën nga rivlerësimi drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara, kur ajo humb kontrollin mbi filialin.
- B99A Nëse një shoqëri mëmë humb kontrollin mbi një filial cili nuk ka biznes, sipas përkufizimit në SNRF 3, si pasojë e një transaksioni që përfshin një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët të kontabilizuar sipas

metodës së kapitalit neto, shoqëria mëmë përcakton fitimin ose humbjen në përputhje me paragrafët B98–B99. Fitimi ose humbja nga transaksioni (përfshirë shumat e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, të cilat do të riklasifikohen në fitim ose humbje sipas kërkesave të paragrafit B99) do të njihet në fitimin ose humbjen e shoqërisë mëmë vetëm në madhësinë e interesave të investitorëve të palidhur me atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Pjesa e mbetur e fitimit do të anulohet kundrejt vlerës kontabël të investimit në atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Gjithashtu nëse shoqëria mëmë mban investime në një ish-filial dhe ky filial tashmë është një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët që trajtohet sipas metodës së kapitalit neto, mëma njihet në fitimin ose humbjen e saj pjesën e fitimit ose humbjes që vjen nga rimatja me vlerën e drejtë të investimit të mbetur në ish-filialin vetëm në madhësinë e interesave të investitorëve të palidhur me pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët të re. Pjesa e mbetur e fitimit do të anulohet kundrejt vlerës kontabël të investimit të mbetur në atë ish-filial. Nëse shoqëria mëmë mban një investim në një ish-filial, i cili tashmë trajtohet në përputhje me SNRF 9, pjesa e fitimit ose humbjes që vjen nga rimatja e investimit të mbetur në ish-filial me vlerën e drejtë do të njihet plotësisht në fitimin ose humbjen e shoqërisë mëmë.

Shembuj zbatimi

Shembulli 17

Një shoqëri mëmë zotëron 100 përqind të interesave në një filial i cili nuk ka biznes. Shoqëria mëmë shet 70 përqind të interesave të saj në filial tek një pjesëmarrje në të cilën zotëron 20 përqind të interesave. Nga ky transaksion, shoqëria mëmë humb kontrollin mbi filialin. Vlera kontabël e aktiveve neto të filialit është 100NJM dhe vlera kontabël e interesave të shitur është 70NJM ($70NJM = 100NJM \times 70\%$). Vlera e drejtë e konsideratës së marrë është 210NJM. Po aq është vlera e drejtë e interesave të shitur. Investimi i mbajtur në ish-filial është një pjesëmarrje që trajtohet sipas metodës së kapitalit neto dhe ka vlerë të drejtë 90NJM. Fitimi i përcaktuar në përputhje me paragrafët B98–B99, para anulimit të kërkuar nga paragrafi B99A, është 200NJM ($200NJM = 210NJM + 90NJM - 100NJM$). Ky fitim përbëhet nga dy pjesë:

- (a) fitimi (140NJM) që vjen nga shitja e 70 përqind të interesave në filial tek pjesëmarrja. Ky fitim është diferenca mes vlerës së drejtë të konsideratës së marrë (210NJM) dhe vlerës kontabël të interesave të shitur (70NJM). Sipas kërkesave të paragrafit B99A, shoqëria mëmë njihet në fitim humbjen e saj shumën e fitimit që i takon interesave të investitorëve të palidhur me pjesëmarrjen ekzistuese. Kjo përbën 80 përqind të këtij fitimi, pra 112NJM ($112NJM = 140NJM \times 80\%$). 20 përqindëshi i mbetur i fitimit ($28NJM = 140NJM \times 20\%$) anulohet kundrejt vlerës kontabël të investimit në pjesëmarrjen ekzistuese.
- (b) fitimi (60NJM) që vjen nga rimatja me vlerën e drejtë të investimit të drejtpërdrejt të mbetur në ish-filial. Ky fitim është diferenca mes vlerës së drejtë të investimit të mbetur në ish-filial (90NJM) dhe 30 përqind të vlerës kontabël të aktiveve neto të pjesëmarrjes ($30NJM = 100NJM \times 30\%$). Sipas kërkesave të paragrafit B99A, shoqëria mëmë njihet në fitim humbjen e saj shumën e fitimit që i takon interesave të investitorëve të palidhur me pjesëmarrjen e re. Kjo përbën 56 përqind ($70\% \times 80\%$) të këtij fitimi, pra 34NJM ($34NJM = 60NJM \times 56\%$). 44 përqindëshi i mbetur i fitimit ($26NJM = 60NJM \times 44\%$) anulohet kundrejt vlerës kontabël të investimit të mbetur në ish-filial.

Kontabiliteti për një ndryshim në statusin e njësisë ekonomike investuese

- B100 Kur një njësi ekonomike pushon së qenuri njësi ekonomike investuese, ajo do të aplikojë SNRF 3 për çdo filial të saj që më parë është matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 31. Data e ndryshimit të statusit, do të konsiderohet si data e blerjes. Vlera e drejtë e filialit në ditën e blerjes do të përfaqësojë shumën e transferuar kur matja e çdo emri të mirë ose humbjeje nga një blerje me okazion që do rrjedhë nga blerja e konsideruar. Të gjitha filialet do të konsolidohen në përputhje me paragrafët 19–24 të kësaj SNRF nga data e ndryshimit të statusit.
- B101 Kur një njësi ekonomike bëhet rishtas njësi ekonomike investuese, ajo do të pushojë së konsoliduari filialet e saj në datën e ndryshimit të statusit, me përjashtim për ndonjë filial i cili do të vazhdojë të konsolidohet në përputhje me paragrafin 32. Njësia ekonomike investuese do të aplikojë kërkesat e paragrafëve 25 dhe 26 për ato filiale që pushoi së konsoliduari sikur njësia ekonomike investuese të kishte humbur kontrollin e këtyre filialeve në atë datë.

Shtojca C

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-ve dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të SNRF-së.

Data e hyrjes në fuqi

- C1 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF përpara datës, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë në të njëjtën kohë SNRF 11, SNRF 12, SNK 27 *Pasqyrat financiare individuale* dhe SNK 28 (të ndryshuar në 2011).
- C1A *Pasqyrat e konsoliduara financiare, Marrëveshjet e përbashkëta dhe deklarimin e interesave të subjekteve të tjera: Udhëzime Tranzicioni* (Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12), të publikuara në qershor 2012, ndryshuan paragrafët C2–C6 dhe shtuan paragrafët C2A–C2B, C4A–C4C, C5A dhe C6A–C6B. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2013. Nëqoftëse njësia ekonomike zbaton SNRF 10 në një periudhë të mëparshme, këto ndryshime zbatohen për atë periudhë të mëparshme.
- C1B *Njësitë ekonomike investuese* (Ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në tetor 2012, ka ndryshuar paragrafët 2, 4, C2A, C6A, dhe Shtojcën A dhe ka shtuar paragrafët 27–33, B85A–B85W, B100–B101 dhe C3A–C3F. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2014. Lejohet zbatimi më i hershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të japë informacion shtesë për këtë fakt dhe të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë ekonomike investuese* në të njëjtën kohë.
- C1C *Shitja ose kontributi i aktiveve mes një investitori dhe pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët përkatëse* (Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28), i publikuar në shtator 2014, ndryshoi paragrafët 25–26 dhe shtoi paragrafin B99A. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospective për transaksione që ndodhin në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës që do të përcaktohet nga BSNK. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- C1D *Njësitë ekonomike investuese: Zbatimi i përjashtimit në konsolidim* (Ndryshime në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28), i publikuar në dhjetor 2014, ndryshoi paragrafët 4, 32, B85C, B85E dhe C2A dhe shtoi paragrafët 4A–4B. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016 e në vijim. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- C1E *Përmirësime Vjetore të Standardeve të Kontabilitetit SNRF—Vëllimi 11*, i publikuar në korrik 2024, ka ndryshuar paragrafin B74. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2026 ose pas kësaj date. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Periudha kalimtare

- C2 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë SNRF në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*,² me përjashtim të asaj që është specifikuar në paragrafët C2A–C6.
- C2A Pavarësisht nga kërkesat e paragrafit 28 të SNK 8, kur ky Standard aplikohet për herë të parë dhe nëse më vonë, kur ndryshimet për *Njësitë ekonomike investuese* dhe *Njësitë ekonomike investuese: Zbatimi i përjashtimit në konsolidim* të këtij Standardi aplikohen për herë të parë, një njësi ekonomike duhet të prezantojë vetëm informacionin sasior të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8 për periudhat vjetore përpara datës së aplikimit fillestar të këtij Standardi ('periudha më e afërt që i paraprin'). Një njësi ekonomike mund ta prezantojë këtë informacion edhe për periudhën aktuale ose për periudha më të hershme krahasuese, por kjo gjë nuk i kërket.

² Kur publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* në prill 2024, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

- C2B Për qëllime të kësaj SNRF, data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës vjetore raportuese për të cilën kjo SNRF zbatohet për herë të parë.
- C3 Në datën e zbatimit fillestar, një njësi ekonomike nuk i kërkohet të bëjë rregullime për trajtimin kontabël të mëparshëm për përfshirjen e saj me ose:
- (a) njësitë ekonomike që do të do të konsolidohen në atë datë në përputhje me SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale* dhe KIS-12 *Konsolidimi—Njësitë ekonomike për qëllime të veçanta* dhe, ende konsolidohen në përputhje me këtë SNRF; ose
 - (b) njësitë ekonomike që nuk të do të konsolidohen në atë datë në përputhje me SNK 27 dhe KIS-12 dhe, nuk janë konsoliduar në përputhje me këtë SNRF;
- C3A Në datën e aplikimit të parë, një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse ajo është një njësi ekonomike investuese mbi bazën e fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë. Në qoftë se, në datën e aplikimit fillestar një njësi ekonomike konkludon se ajo është një njësi ekonomike investuese, ajo do të aplikojë kërkesat e paragrafëve C3B-C3F në vend të paragrafëve C5-C5A.
- C3B Përveç ndonjë filiali që është konsoliduar në përputhje me paragrafin 32 (për të cilin aplikohen ose paragrafët C3 dhe C6 ose paragrafët C4-C4A, cilido qoftë i përshtatshëm), një njësi ekonomike investuese do të masë investimet e saj në vlerën e drejtë nëpërmjet Fitimit ose Humbjes sikur kërkesat e kësaj SNRF të kishin qenë gjithmonë në fuqi. Njësia ekonomike investuese duhet që në mënyrë retrospektive të rregullojë si periudhën vjetore më të afërt që paraprin datën e aplikimit fillestar, ashtu dhe kapitalin neto në fillim të periudhës më të afërt që i paraprin për çdo diferencë midis:
- (a) vlerës kontabël të filialit; dhe
 - (b) vlerës së drejtë të investimit që njësia ekonomike investuese ka bërë në filial.
- Shuma e akumuluar e çdo një rregullimi të mëparshëm i njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse do të transferohet tek fitime të pa shpërndara në fillim të periudhës vjetore që i paraprin datës së aplikimit.
- C3C Përpara datës së adoptimit të SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*, një njësi ekonomike investuese duhet të përdorë shumat e vlerës së drejtë që më parë janë raportuar tek investitorët ose tek drejtuesit, në qoftë se këto shuma përfaqësojnë shumat për të cilat investimi mund të ishte këmbyer midis palëve të vullnetshme në një transaksion midis palëve të palidhura, në datën e vlerësimit.
- C3D Në qoftë se matja e një investimi në një filial në përputhje me paragrafët C3B-C3C është praktikisht e pa mundur (siç përcaktohet në SNK 8), një njësi ekonomike investuese do të aplikojë kërkesat e kësaj SNRF në fillim të periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i paragrafëve C3B-C3C është i praktikueshëm, e cila mund të jetë dhe periudha aktuale. Investitori në mënyrë retrospektive do të rregullojë periudhën vjetore më të afërt që i paraprin datës së aplikimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është praktikisht i mundshëm përkon me periudhën aktuale. Në qoftë se është ky rasti, atëherë rregullimi në kapitalin neto do të njihet në fillim të periudhës aktuale.
- C3E Në qoftë se një njësi ekonomike investuese, ka shitur ose ka humbur kontrollin e një investimi në një filial përpara datës së aplikimit fillestar të kësaj SNRF, njësisë ekonomike investuese nuk i kërkohet të bëjë rregullime të mënyrës së kontabilizimit të mëparshëm për këtë filial.
- C3F Në qoftë se një njësi ekonomike, aplikon ndryshimet *Njësitë ekonomike investuese* për një periudhë të mëvonshme sesa kur ajo ka aplikuar SNRF 10 për herë të parë, referencat për "data e aplikimit fillestar" në paragrafët C3A-C3E duhet të lexohen si "fillimi i periudhës raportuese vjetore për të cilën ndryshimet në *Njësitë ekonomike investuese* (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), të publikuara në tetor 2012, janë aplikuar për herë të parë."
- C4 Kur zbatimi për herë të parë i këtij SNRF-je, bën që një investitor të konsolidojë një të investuar që nuk është konsoliduar në përputhje me SNK 27 dhe KIS-12, investitori:
- (a) do të masë aktivet, detyrimet dhe interesat jo-kontrolluese në këtë të investuar të pa konsoliduar më parë, në datën e fillimit të zbatimit, sikur ky i investuar të kishte qenë i konsoliduar (dhe zbatohet në këtë mënyrë kontabiliteti i blerjes në përputhje me SNRF 3) nga data kur investitori ka siguruar kontrollin mbi këtë të investuar në bazë të kërkesave të këtij SNRF-je, në qoftë se i investuari është një biznes (siç përkufizohet në SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*). Investitori do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar. Kur data që kontrolli është marrë është më herët se fillimi i periudhës më të hershme, investitori do të njohë, si një rregullim në kapitalin e vet në fillim të periudhës më të hershme, ndonjë diferenca midis:
 - (i) shumën e aktiveve, detyrimeve dhe interesave jo-kontrolluese njihet; dhe
 - (ii) vlera kontabël e mëparshme e përfshirjes së investitorit në investim.

- (b) do të matë aktivet, detyrimet dhe interesat jo-kontrolluese në këtë të investuar të pa konsoliduar më parë, në datën e fillimit të zbatimit, sikur ky i investuar të kishte qenë i konsoliduar (duke zbatuar metodën e blerjes siç përshkruhet në SNRF 3, pa njohur ndonjë emër të mirë për të investuarin) nga data kur investitori ka siguruar kontrollin mbi këtë të investuar, në bazë të kërkesave të këtij SNRF-je, në qoftë se i investuari nuk është një biznes (siç përkufizohet në SNRF 3). Investitori do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar. Kur data që kontrolli është marrë është më herët se fillimi i periudhës më të hershëm, investitori do të njohë, si një rregullim në kapitalin e vet në fillim të periudhës më të hershme, ndonjë diferenca midis:
- (i) shumën e aktiveve, detyrimeve dhe interesave jo-kontrolluese njihet; dhe
 - (ii) vlera kontabël e mëparshme e përfshirjes së investitorit në investim.
- C4A Nëse matja e aktiveve, detyrimeve dhe interesit jo kontrollues të një të investuari, në përputhje me paragrafët C4(a) ose (b), është e pazbatueshme (siç përkufizohet në SNK 8), investitori:
- (a) nëse investuesi është një biznes, do të zbatojë kërkesat e SNRF 3 në datën e supozuar të blerjes. Data e supozuar e blerjes do të jetë fillimi i periudhës më të hershme, që mund të jetë edhe periudha aktuale, për të cilën është i zbatueshëm paragrafi C4(a).
 - (b) nëse i investuari nuk është një biznes, do të zbatojë metodën e blerjes, siç përshkruhet në SNRF 3, pa njohur asnjë emër të mirë për të investuarin, që nga data e supozuar e blerjes. Data e supozuar e blerjes do të jetë fillimi i periudhës më të hershme, që mund të jetë edhe periudha aktuale, për të cilën është i zbatueshëm paragrafi C4(a).
- Investitori në mënyrë retrospektive do të rregullojë periudhën vjetore më të afërt që i paraprin datës së aplikimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është praktikisht i mundshëm përkon me periudhën aktuale. Kur data që kontrolli është marrë është më herët se fillimi i periudhës më të hershëm, investitori do të njohë, si një rregullim në kapitalin e vet në fillim të periudhës më të hershme, ndonjë diferenca midis:
- (c) shumën e aktiveve, detyrimeve dhe interesave jo-kontrolluese njihet; dhe
 - (d) vlera kontabël e mëparshme e përfshirjes së investitorit në investim.
- Në qoftë se periudha më e hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është i mundshëm është periudha aktuale, rregullimi i kapitalit neto do të njihet në fillim të periudhës aktuale.
- C4B Kur një investitor zbaton paragrafët C4-C4A dhe datën që kontrolli është marrë në përputhje me këtë SNRF është më vonë se data efektive e SNRF 3 i rishikuar në 2008 (SNRF 3 (2008)), referencë për SNRF 3 në paragrafët C4 dhe C4A do të jetë për të SNRF 3 (2008). Nëse kontrolli është marrë përpara hyrjes në fuqi të SNRF 3 (2008), një investitor do të zbatohen ose SNRF 3 (2008) ose SNRF 3 (publikuar në 2004).
- C4C Kur një investitor zbaton paragrafët C4-C4A dhe datën që kontrolli është marrë në përputhje me këtë SNRF është më vonë se data efektive e SNRF 27 i rishikuar në 2008 (SNK 27 (2008)), një investitor do të zbatojnë kërkesat e kësaj SNRF për të gjitha periudhat që i investuari është i konsoliduar në mënyrë retrospektive në përputhje me paragrafët C4-C4A. Nëse kontrolli është marrë përpara hyrjes në fuqi të SNK 27 (2008), një investitor do të aplikohet ose:
- (a) kërkesat e kësaj SNRF për të gjitha periudhat që i investuar është i konsoliduar në mënyrë retrospektive në përputhje me paragrafët C4-C4A; ose
 - (b) kërkesat e versionit të SNK 27 publikuar në 2003 (SNK 27 (2003)) për ato periudha e para të hyrjes në fuqi të SNK 27 (2008) dhe pas kësaj kërkesat e kësaj SNRF për periudhat e mëvonshme.
- C5 Nëse, në datën e zbatimit fillestar, një investitor arrin në përfundimin se ai do të konsolidojë një investim që ishte konsoliduar në përputhje me SNK 27 dhe KIS-12, investitori do të masë interesin e saj në investim në vlerën me të cilën ajo do të ishte matur nëse kërkesat e kësaj SNRF kanë qenë efektive kur investitori u përfshi (por jo të marrë kontrollin në përputhje me këtë SNRF), apo humbi kontrollin e, të investuarit. Investitori do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar. Kur data që investitori u përfshi në (por nuk mori kontroll në përputhje me këtë SNRF), ose humbi kontrollin e, investitori është më herët se fillimi i periudhës menjëherë para, investitori do të njohë, si një rregullim në kapitalin neto në fillim të periudhës menjëherë para, ndonjë diferenca midis:
- (a) vlera kontabël e mëparshme e aktiveve, detyrimeve dhe interesave jo-kontrolluese; dhe
 - (b) vlerës së drejtë të investimit që investitori ka bërë në filial.
- C5A Në qoftë se matja e një investimi në një filial në përputhje me paragrafin C5 është praktikisht e pa mundur (siç përcaktohet në SNK 8), një njësi ekonomike investuese do të aplikojë kërkesat e kësaj SNRF në fillim të periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i paragrafit C5 është i praktikueshëm, e cila mund të jetë

dhe periudha aktuale. Investitori në mënyrë retrospektive do të rregullojë periudhën vjetore më të afërt që i paraprin datës së aplikimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është praktikisht i mundshëm përkon me periudhën aktuale. Kur data që investitori u përfshi në (por nuk mori kontroll në përputhje me këtë SNRF), ose humbi kontrollin e, investitori është më herët se fillimi i periudhës menjëherë para, investitori do të njohë, si një rregullim në kapitalin neto në fillim të periudhës menjëherë para, ndonjë diferenca midis:

- (a) vlera kontabël e mëparshme e aktiveve, detyrimeve dhe interesave jo-kontrolluese; dhe
- (b) vlerës së drejtë të investimit që investitori ka bërë në filial.

Në qoftë se periudha më e hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është i mundshëm është periudha aktuale, rregullimi i kapitalit neto do të njihet në fillim të periudhës aktuale.

C6 Paragrafët 23, 25, B94 dhe B96-B99 në SNK 27 u ndryshuan në vitin 2008, ndryshime që janë të bartura në SNRF 10. Përveç rasteve kur një njësi ekonomike zbaton paragrafin C3, ose i kërkohet të zbatojë paragrafët C4–C5A, njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat në këta paragrafë si në vijim:

- (a) Një njësi ekonomike nuk do të riparaqesë caktimin e fitimit ose të humbjes për periudhat raportuese para se të zbatohet për herë të parë ndryshimi në paragrafin B94.
- (b) Kërkesat në paragrafët 23 dhe B96 për kontabilitetin e ndryshimeve në interesat e pronësisë në një filial pasi është siguruar kontrolli, nuk zbatohen për ndryshimet që kanë ndodhur para se një njësi ekonomike të ketë zbatuar për herë të parë këto ndryshime.
- (c) Një njësi ekonomike nuk do të riparaqesë vlerën kontabël të një investimi në një ish –filial, në qoftë se ka humbur kontrollin para se të jenë zbatuar për herë të parë ndryshimet në paragrafët 25 dhe B97-B99. Përveç kësaj, një njësi ekonomike nuk do të rillogarisë asnjë humbje apo fitim nga humbja e kontrollit mbi një filial, që ka ndodhur para se të zbatoheshin për herë të parë ndryshimet në paragrafët 25 dhe B97-B99.

Referencat për `periudhat e mëparshme`

- C6A Pavarësisht referencës për periudhën vjetore që menjëherë i paraprin datës së aplikimit fillestar ("periudha më e hershme pararendëse") në paragrafët C3B–C5A, një njësi ekonomike mundet gjithashtu të prezantojë informacion krahasues për çdo periudhë më të hershme të paraqitur, por kjo nuk i kërkohet. Në qoftë se një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme, të gjitha referencat për "periudhën më të hershme pararendëse" në paragrafët C3B–C5A do të lexohet si "periudha më e hershme krahasuese e rregulluar".
- C6B Në qoftë se një njësi ekonomike prezanton informacion krahasues të pa rregulluar për ndonjë periudhë të më hershme, ajo do të identifikojë qartazi që informacioni nuk është i rregulluar, të deklarojë që informacioni është përgatitur mbi baza të ndryshme, dhe t'i shpjegojë këto baza.

Referencat në SNRF 9

- C7 Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF, por ende nuk zbaton SNRF 9, çdo referencë në SNRF 9 do të lexohet si një referencë në SNK 39 *Instrumentet financiarë: Njohja dhe matja*.

Shfuqizimi i SNRF-ve të tjera

- C8 Ky SNRF zëvendëson kërkesat në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara në SNK 27 (i ndryshuar në 2008).
- C9 Ky SNRF zëvendëson edhe KIS-12 *Konsolidimi-Njësi ekonomike për qëllime të veçanta*.